



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 285 Akti**

**Nr. 343 Vendimi**  
**Tiranë, më 11.2.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Lulzim Hamitaj</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	<b>Relatore</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Elda Faruku, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova, më 9.2.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elsa Miha, me detyrë** prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## **TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Miha, aktualisht me funksionin prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio* në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, pas zhvillimit të procedurës së shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykues më 15.3.2019, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Miha, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët znj. Genta Tafa (Bungo), znj. Suela Zhegu dhe z. Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja znj. Genta Tafa (Bungo).

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 20.3.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues znj. Suela Zhegu, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, znj. Elsa Miha.

5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, znj. Elsa Miha, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës” të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**8.** Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale” të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**9.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e në vijim “ILDKPKI”); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e në vijim “DSIK”); dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (këtu e në vijim “KLP”). Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** ILDKPKI-ja dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit është konstatuar se:

- a) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) ka kryer deklarim të rremë;*
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklaramëve dhe të dhënave të tjera, për të identifikuar nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup>, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së znj. Elsa Miha.

**12.** Këshilli i Lartë i Prokurorisë (“KLP”) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: atë të vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriteret e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 21.1.2021 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit

<sup>1</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2018.

<sup>2</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 11.9.2019.

<sup>3</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12. 6.2020.

për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës për të paraqitur prova dhe shpjegime për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, po në të njëjtën datë, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit të zhvilluar kryesisht nga Komisioni. Subjekti, me e-mail-in e datës 22.1.2021 ka kërkuar shtyrjen e afatit për t'u njohur me dosjen. Pas pranimit të kërkesës, u caktua si afat i fundit data 5.2.2020. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 26.1.2021, ndërsa më 4.2.2021 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

**16.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore<sup>4</sup>.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**17.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 5.2.2021.

**18.** Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më 9.2.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Elka Ermenkova.

**19.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Miha, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**20.** Znj. Elsa Miha ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**20.1** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**21.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

---

<sup>4</sup> Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 5.2.2021.

**21.1.** Referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017<sup>5</sup> dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**22.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLP-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**23.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 26.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**24. Apartament<sup>6</sup>,** në pronësi, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>.

**(i) vlera e deklaruar** 4.200.000 lekë; **(ii) pjesa takuese:** 50%; **(iii) subjekti** ka deklaruar se e ka fituar këtë pasuri nëpërmjet kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2008.

**24.1. Burimi i deklaruar i pasurisë:** kredia e marrë më 12.3.2008 në Bankën Kombëtare Tregtare në shumën 50,000 euro.

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

<sup>6</sup> Subjekti ka dorëzuar: (i) vërtetim nga dokumentet hipotekore nr. \*\*\*, datë 3.7.2008, të pasurisë me nr. \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, me sipërfaqe 88.05 m<sup>2</sup>; (ii) kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2008; (iii) kontratë kredie bankare nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.3.2008; (iv) vërtetim, datë 24.10.2016, nga banka “BKT”.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- *Deklarim i rremë lidhur me vlerën e apartamentit me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, ndodhur në Fier, pasi deklarimi i subjektit dhe kontrata e shitjes kanë vlerën 4,200,000 lekë, ndërsa referuar statement-it të BKT-së, rezulton se shuma për likuidim apartamenti është 49,100 euro (e konvertuar rreth 6,000,000 lekë).*
- *Kontrata për shitjen e apartamentit me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, në shumën 4.200.000 lekë është bërë me qëllim shmangien e detyrimeve tatimore.*

### **Hetimi<sup>7/</sup> analiza ligjore - financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**24.2.** Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 18.6.2008, bashkëshorti i subjektit ka blerë “apartament”, nr. \*\*\*, kati i \*\*\*-të i banimit, me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>, në Fier, me vlerë 4,200,000 lekë. Në kontratë përcaktohet se vlera është likuiduar tërësisht para redaktimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. Bazuar në shkresën e ZVRPP-së Fier, apartamenti është i regjistruar në emër të z.V. M., me numër pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*.

**24.3.** Si burim për blerjen e apartamentit subjekti ka deklaruar kredinë e marrë në BKT. Konstatohet nga dokumentacioni se me kontratën e kredisë bankare<sup>8</sup> nr. \*\*\*, datë 12.3.2008, bashkëshorti i subjektit ka marrë kredi në vlerën 50, 000 euro, me afat 120 muaj nga Banka Kombëtare Tregtare.

**24.3.1.** Në nenin 3.4. të kontratës së kredisë deklarohet se shuma 50, 000 euro do të transferohet tek shitësi Sh. S.. Nga ana tjetër, ky fakt konfirmohet dhe nga llogaria bankare e z. V. M. në BKT, nga ku rezulton se, nga vlera e kredisë së marrë, shuma 49.100 euro i është transferuar shitësit më 28.3.2008, pra, tre muaj përpara se të lidhej kontrata e shitblerjes. PAGESA është transferuar në llogarinë e z. Sh. S. në “ProCredit Bank” në datën 1.4.2008.

**24.3.2.** Duke qenë se shuma e kaluar në rrugë bankare për blerjen e apartamentit ishte 49,100 euro, ndërsa çmimi i blerjes së apartamentit sipas kontratës së shitblerjes 4, 200, 000 lekë, u pyet subjekti në lidhje me këtë transferim, për të cilin, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, sqaron se:

*“... shuma e paguar për blerjen e apartamentit është 4.200.000 lekë, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2008. Fillimisht nga ana e tyre është lidhur kontrata e shitjes së një sendi në të ardhmen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.3.2008 për një apartament me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, për çmimin 60.000 euro, i cili, sikundër është cituar shprehimisht edhe në kontratë do të shlyhej tërësisht nëpërmjet kredisë, që do të merrej brenda një muaji. Mbi këtë bazë është kërkuar nga ana e tyre një kredi në shumën 60.000 euro, por Banka nuk e ka pranuar kërkesën për shumën e plotë, duke dhënë kredi bankare në shumën 50.000 euro. Pas kryerjes së këtij veprimi, të ndodhur në vështirësi për të paguar apartamentin në shumën 60.000 euro, u ra dakord me palën shitëse për të blerë një apartament tjetër më të vogël, me sipërfaqe 88.05 m<sup>2</sup>, vlera e të cilit shkonte 4.200.000 lekë... Në këto kushte pala shitëse na ka kthyer mbrapsht pjesën tjetër të shumës, që i ishte kaluar paraprakisht nga Banka dhe që rezultonte 1.800.000 lekë. Edhe vlera e tregut të shitjes së*

<sup>7</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020, drejtuar ASHK Fier; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.09.2019, drejtuar bankave; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019, drejtuar OSHEE-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar BKT-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 29.4.2020, drejtuar “ProCredit Bank”.

<sup>8</sup> Dorëzanës janë subjekti i rivlerësimit, S. S. dhe D. S.. Sipas kontratës, kredimarrësi dhe dorëzanësit garantojnë kredinë nëpërmjet pasurisë së paluajtshme “truall dhe shtëpi banimi” me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>, në Vlorë, e cila është vënë në hipotekë me kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 12.3.2008.

*apartamenteve në Fier, në vitin 2008 nuk e justifikon blerjen e një apartamenti bosh 88.05 m<sup>2</sup> për 50.000 euro.”*

Për të vërtetuar pretendimet e saj, subjekti ka vënë në dispozicion:

- Mandatpagesë të palës shitëse nr. \*\*\*, datë 18.6.2008, nëpërmjet të cilit zotit V. M. i kthehet shuma 1,800,000 lekë nga z. Sh. S..
- deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 11.5.2020, e shtetasit Sh. S..

**24.3.3.** Nga hetimi ka rezultuar se:

- (i) bashkëshorti i subjektit në datën 6.3.2008<sup>9</sup> ka lidhur kontratë shitjeje të një sendi në të ardhmen nr. \*\*\*, me z. Sh. S. për blerjen e një apartamenti me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, në katin e \*\*\*-të të banimit, me vlerë 400 euro/ m<sup>2</sup>;
- (ii) me kontratë kredie bankare nr. \*\*\*, datë 12.3.2008, bashkëshorti i subjektit ka marrë kredi në vlerën 50, 000 euro;
- (iii) Shuma e lëvruar nga kredia prej 49, 100 euro i ka kaluar shitësit Sh. S. në llogari bankare më 28.3.2008;
- (iv) nga nxjerrja e llogarisë<sup>10</sup> së z. Sh. S. rezulton se ai ka tërhequr shumën 20, 000 euro më 6.6.2008;
- (v) Komisioni ka administruar mandatpagesën e palës shitëse nr. \*\*\*, datë 18.6.2008, nëpërmjet të cilit zotit V. M. i kthehet shuma 1, 800, 000 lekë nga z. Sh. S.;
- (vi) kontrata e shitjes së një sendi në të ardhmen nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.3.2008 është lidhur për apartament me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, për shumën 60, 000 euro, ndërsa kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2008 është për apartament me sipërfaqe 88.5 m<sup>2</sup>. Nga përlllogaritja rezulton pothuajse i njëjti çmim për metër katror;
- (vii) kontrata e shitblerjes së apartamentit dhe mandatpagesa për kthimin e diferencës së shumës kanë të njëjtën datë.

Për sa më sipër rezulton se shpjegimet e subjektit përputhen me të dhënat e administruar gjatë hetimit, duke u provuar fakti që apartamenti është blerë në shumën 4,200,000 lekë dhe bashkëshortit të subjektit i është kthyer shuma 1,800,000 lekë.

**24.3.4.** Kredia është shlyer në datën 5.10.2015 nëpërmjet depozitimit të shumës 16, 915 euro nga bashkëshorti i subjektit. Ky fakt vërtetohet dhe nga nxjerrja e llogarisë së z. V. M. në BKT. Si burim për këtë shumë, subjekti ka deklaruar huan e marrë nga z. B. S.(trajtuar më poshtë).

**24.4.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se shuma 2,800,000 lekë, mbetur nga kredia, ka shërbyer: 980,000 lekë për blerjen e automjetit, ndërsa pjesa tjetër 1,820,000 lekë për mobilimin e apartamentit. I njëjti deklaram është bërë dhe përpara ILDKPKI-së<sup>11</sup> bazuar në procesverbalin e datës 26.1.2016.

Në lidhje me këtë mospërputhje subjekti sqaron se: *“Sikundër në procesverbalin e pyetjes pranë ILDKPKI, në pyetësorin standard, por edhe në deklaratat periodike të pasurisë, kam deklaruar të njëjtin fakt, që pjesa e kthyer e kredisë së marrë në shumën, 1.800.000 lekë është përdorur për blerjen e automjetit tip “\*\*\*”, me targa \*\*\* dhe pjesa tjetër për mobilimin e apartamentit. Automjeti është blerë në shumën 980.000 lekë, ndaj pjesa tjetër prej 800.000 lekësh ka shërbyer për mobilimin e shtëpisë...”*

<sup>9</sup> Kthim përgjigjeje BKT-ja nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2020.

<sup>10</sup> Shkresë nr. OP-\*\*\* prot., datë 18. 6.2020 e “ProCredit Bank” për llogarinë bankare.

<sup>11</sup> Shih shkresën nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020.

**24.5.** Në lidhje me këtë apartament në pyetësin standard subjekti ka deklaruar si vijon: “Nga viti 2005 deri në vitin 2015 kam banuar në Fier, në adresën: lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*” pallati nr. \*\*\*, kati i \*\*\*, apartament në pronësi, sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 18.6.2008”.

**24.5.1.** Në përgjigje të pyetësit të datës 9.11.2020 subjekti ka saktësuar se deri në korrik të vitit 2008 ka qëndruar me qira në një apartament 1+1, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Fier, në pronësi të shtetasës L. D., sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2005, rinovuar me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.10.2006. Apartamentin me qira në Fier e ka marrë në tetor të vitit 2005, pasi në këtë kohë mori emërimin për të ushtruar detyrën e prokurorit në Fier. Deri në këtë kohë, banonte në Kuçovë së bashku me familjen e bashkëshortit, pasi sikundër e ka shpjeguar edhe më parë, ka qenë duke kryer stazhin si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat. Lidhur me vlerën e qirasë sqaron se ka qenë në shumën 12,500 (dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj, sikundër është përcaktuar edhe në kontratën e qirasë.

**24.5.2.** Subjekti ka bashkëlidhur: (i) kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 31.10.2005, nëpërmjet së cilës z. V. M. ka marrë me qira nga znj. L. D. apartament, për një vit, në shumën 12,500 lekë/muaj; (ii) kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 11.10.2006, nëpërmjet së cilës subjekti ka marrë me qira nga znj. L. D. apartament, për një vit, në shumën 12, 500 lekë/muaj.

**24.5.3.** Ky deklaram i subjektit përputhet dhe me të dhënat e administruara, nga ku rezulton se bazuar në aktin e kolaudimit<sup>12</sup> të objektit, ku ndodhet apartamenti i subjektit, ndërtimi i objektit ka filluar më 9.9.2005 dhe ka përfunduar në datën 14.8.2006.

**24.6.** Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti.

	<b>2008</b>
<b>Pasuri</b>	<b>5 037 322</b>
Apartament 2+1, lagjja “****”, Fier	4 200 000
Shtesa/pakësime, likuiditete	837 322
Likuiditete gjendje	1 416 226
<b>Të ardhura të dokumentuara</b>	<b>7 738 668</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	933 092
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	355 576
Të ardhura nga biznesi i bashkëshortit (sipas deklarimeve) DPV)	240 000 <sup>13</sup>
Kredi nga BKT-ja, 50,000 euro	6 210 000
<b>Shpenzime</b>	<b>2 599 036</b>
Shpenzime jetese	409 860
Shpenzime udhëtimi, TIMS	276 568
Pagesa e kësteve për kredinë 50,000 euro	593 171

<sup>12</sup> Shih kthim përgjigjeje ASHK-ja Fier, nr. \*\*\* prot., datë 18.5.2020.

<sup>13</sup> Fitimi i aktivitetit është konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike për sa kohë që nga llogaritja e kryer, duke zbritur detyrimet tatimore dhe shpenzimet për këtë aktivitet me një xhiro 2,000,000 lekë, fitimi do të ishte shumë më i lartë se ai i deklaruar nga subjekti. Duke mbajtur këtë qëndrim konservativ, fitimi nga aktiviteti do të konsiderohet neto dhe nga ai nuk do të zbriten shpenzimet për çeljen e aktivitetit dhe ato të qirasë.



Shpenzime kredie	94 687
Shpenzime mobilimi	820 000
Shpenzime qiraje	87 500
Shpenzime për aktivitetin e bashkëshortit	230 000
Shpenzime shkollimi, djali K. M.	84 500
Shpenzime hipotekore	2 750
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>102,310</b>

**24.6.1.** Vlera e apartamentit është marrë ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, pra 4, 2 milion lekë;

**24.6.2.** Nga shuma e kthyer, 800,000 lekë janë përdorur nga subjekti për mobilimin e apartamentit dhe pjesa e mbetur është përdorur për makinën (shiko më poshtë pika 27).

**24.7.** Për sa më sipër, arrihet në përfundimin se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit.

**25. Apartament<sup>14</sup>,** me përbërje 3+1, me sipërfaqe 138.53 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, të cilin e ka pasur në përdorim, sipas kontratës së huapërdorjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.9.2016. Vlera e apartamentit 124, 000 euro.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhurat e vëllait nga emigracioni.

#### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- *Është e paqartë nëse është paguar nga ana e shtetasit M. B. deri në vitin 2017 e gjithë shuma për blerjen e apartamentit me sip. 138.53 m<sup>2</sup> në Tiranë, në vlerën totale sipas kontratës 124,000 euro dhe mungesë burimi financiar të ligjshëm nga ana e këtij shtetasi për pagesat e kryera.*

#### **Hetimi<sup>15</sup>/ analiza ligjore - financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**25.1.** Në datën 5.6.2012, me kontratë premtim shitjeje nr. \*\*\*, nënshkruar ndërmjet palës shitëse, shoqërisë “\*\*\*\*” dhe palës blerëse, z. M. B. (vëllai i subjektit), si edhe palës dhënëse të pëlqimit, shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., z. M. B. ka blerë (premtim shitje) një apartament me sipërfaqe 138.53 m<sup>2</sup>, në vlerën 124,000 euro. Sipas kontratës, shlyerja do të kryhej me këste. Kësti i parë prej 60, 000 euro është likuiduar ditën e nënshkrimit të kontratës, kësti i dytë prej 60, 000 euro do të likuidohej brenda 5 vjetëve, ndërsa diferenca prej 4, 000 euro do të paguhej në momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare.

<sup>14</sup> Subjekti ka dorëzuar: (i) kontratë premtim shitjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 5.6.2012; (ii) kontratë huapërdorjeje (të pasurisë së paluajtshme) nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., datë 2.9.2016; (iii) deklaratë e nënshkruar në datën 17.5.2012 nga shoqëria “\*\*\*\*” dhe z. M. B.; (iv) mandatpagesë, datë 11.1.2013 nga “Raiffeisen Bank”; mandatpagesë, datë 23.9.2013 nga “Raiffeisen Bank”; (v) depozitim *cash* në datën 22.1.2015 në llogarinë bankare të shoqërisë “\*\*\*\*” në bankën “BKT”; (vi) dokumentacion të shtetit grek për të ardhurat e vëllait të subjektit, z. M. B..

<sup>15</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019 drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar bankave; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar shoqërisë “\*\*\*\*”; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar QKB-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 26. 5.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.8.2020, drejtuar Bashkisë Patos.

**25.2.** Për të vërtetuar pagesën e apartamentit nga vëllai i saj, subjekti ka vënë në dispozicion: (i) deklaratë, e nënshkruar në datën 17.5.2012 nga shoqëria “\*\*\*\*” dhe z. M. B. për shitjen e një apartamenti me sipërfaqe 138.53 m<sup>2</sup>, në vlerën totale 124, 667 euro dhe shlyerjen e shumës 60, 000 euro nga blerësi M. B.;

- i. mandatpagesë, datë 11.1.2013, të “Raiffeisen Bank”, me urdhërues z. M. B. dhe përfitues shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., për pagesën e shumës 14.850 euro;
- ii. mandatpagesë, datë 23.9.2013, të “Raiffeisen Bank”, me urdhërues z. M. B. dhe përfitues H. K., përfaqësues i shoqërisë “\*\*\*\*”, për pagesën e shumës 10.150 euro;
- iii. depozitim në *cash* në datën 22.1.2015 në llogarinë në bankën “BKT” të shoqërisë “\*\*\*\*” nga znj. F. B. (nëna e subjektit), në shumën 4, 320 Euro.

Në total, vëllai i subjektit ka paguar shumën 89, 320 euro. Kjo shumë konfirmohet dhe nga shoqëria “\*\*\*\*”.

**25.3.** Zoti M. B. apartamentin e mësipërm ia ka dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit për qëllim banimi, pa afat, përmes kontratës së huapërdorjes nr. 3698/2310, datë 2.9.2016.

**25.4.** Në lidhje me këtë apartament në seksionin të dhëna konfidenciale të deklaratës “Vetting”, subjekti ka sqaruar se: *“Për shkak të transferimit tim dhe të bashkëshortit me punë nga Fieri në Tiranë, për nevoja banimi, kam marrë në përdorim nga vëllai M. B. (që banon në Patos) një apartament 3+1, në rrugën “\*\*\*\*” Tiranë, i deklaruar më sipër sipas kontratës së huapërdorjes nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 2.9.2016. ... Në funksion të këtij deklarimi më ka shpjeguar se gjithçka e ka fituar nga emigracioni në Greqi, i ka investuar për blerjen e këtij apartamenti dhe se nuk ka pasuri apo ndonjë aktivitet tregtar. Në Greqi vëllai ka punuar 15 vjet, nga ku 5 vjet në aeroportin e ri, që u ndërtua në Athinë, ku pagesat kanë qenë relativisht të mira dhe ka siguruar edhe pjesën më të madhe të të ardhurave.”*

**25.5.** Nga shqyrtimi i deklarimeve të subjektit Komisioni ka konstatuar se: (i) subjekti ka deklaruar përpara ILDKPKI-së<sup>16</sup>, bazuar në procesverbalin e datës 26.1.2016, se jeton në këtë apartament që nga prilli i vitit 2015; (ii) në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se ka jetuar në këtë apartament nga shtatori i vitit 2016; (iii) në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti deklaroi se ka filluar të jetojë në këtë apartament nga janari i vitit 2016.

**25.5.1.** Për shkak të mospërputhjeve në këto deklarime, në rezultatet e hetimit Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit.

**25.5.2.** Në parashtrimet e saj subjekti ka sqaruar se lidhur me momentin kur ka filluar të banojë në banesën e vëllait, ka qenë e pasaktë *vetëm në një rast* dhe ka qenë *në pyetësorin standard*, kur ka deklaruar se ka hyrë në banesë në shtator të vitit 2016<sup>17</sup>, pasaktësi që e ka sqaruar më pas në pyetësorin nr. 1 të datës 4.5.2020<sup>18</sup>. Në përgjigje të këtij pyetësori subjekti ka deklaruar se ka filluar ta përdorë banesën e vëllait *në janar të vitit 2016* dhe këtë përgjigje e “*...kam dhënë pasi e kam konsultuar memorien time edhe me dokumentat që hedhin dritë mbi këtë moment, të cilat u janë dërguar<sup>19</sup> bashkëlidhur përgjigjeve të mëparshme*”.

<sup>16</sup> Shih kthim përgjigjen e ILDKPKI-së nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020.

<sup>17</sup> Duhet t'i jem referuar kontratës së huapërdorjes.

<sup>18</sup> Shih fq. nr. 6, përgjigje për pyetjen nr. 6.

<sup>19</sup>Kontrata e qirasë datë 5.4.2015 për apartamentin në rrugën “\*\*\*\*” si dhe mandatpagesat e kësaj qiraje, nga të cilat provohet se nga muaji prill 2015 deri në dhjetor të vitit 2015 kam banuar me qira në adresën e mësipërme; deklarata e pasurisë të vitit 2015, librezat e ujit dhe të dritave për apartamentin e vëllait etj.

Në përgjigjet e pyetësorit të parë, subjekti ka shpjeguar gjithashtu se, edhe kur është pyetur në ILDKPKI, ka deklaruar të njëjtat rrethana sikundër është përgjigjur në pyetësorin e parë. Sipas subjektit: *“Kam shpjeguar gjithashtu se prilli i vitit 2015, që është shkruar në procesverbalin e pyetjes në ILDKPKI, është deklaruar prej meje si koha kur kam banuar me qira<sup>20</sup> në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, ndërkohë që banesën e vëllait tim, në rrugën “\*\*\*”, e kam dhënë si adresë ku banoja në momentin që jam pyetur. Rrethanat e deklaruara prej meje nuk janë pasqyruar drejt në procesverbal, ndoshta për shkak të pakujdesisë së personit që e ka mbajtur atë, pasi nuk gjej arsye tjetër.”*

Në përfundim, subjekti arsyeton se: *“Nuk ka asnjë arsye apo interes të caktuar që unë të deklaroja si hyrje në banesën e vëllait, muajin prill të vitit 2015, sikundër është shprehur në procesverbalin e deklaramit të marrë nga ILDKPKI, apo çfarëdo date tjetër pasi:*

*(i) nga prilli i vitit 2015 deri më dhjetor të vitit 2015 kam banuar me qira në rrugën “\*\*\*”, Tiranë, çka konfirmohet nga kontrata e qirasë datë 5.4.2015 lidhur me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k. dhe mandatpagesat përkatëse;*

*(ii) faktin se që nga prilli i vitit 2015 deri në dhjetor të vitit 2015, banoja me qira në rrugën “\*\*\*” Tiranë, nuk e kam fshehur në asnjë rast, por e kam deklaruar rregullisht sa herë më është kërkuar. Kjo rrethanë është deklaruar edhe në deklaratën përkatëse të pasurisë të vitit 2015 në rubrikën e adresës, por edhe të detyrimeve financiare;*

*(iii) në prill të vitit 2015, hyrja e vëllait tim dhe që përdoret sot nga unë, nuk ka qenë e banueshme”;*

Subjekti ka përfunduar arsyetimin se ka filluar të banojë në banesën e vëllait në janar të vitit 2016 dhe se lapsusi në datën e dhënë ka qenë vetëm në përgjigjen e dhënë për pyetësorin standard.

**25.5.3.** Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit, i konsideron ato bindëse. Është provuar me dokumentacion se subjekti ka jetuar me qira në periudhën prill 2015 - dhjetor 2015, për të cilën subjekti ka depozituar kontratën e qirasë, e ka deklaruar si adresë në DVP/2015. Nga ana tjetër, apartamenti i vëllait të saj ka përfunduar në vitin 2015. Kjo provohet edhe nga faturat e energjisë elektrike (pagesat kanë filluar në shkurt të vitit 2016) dhe ato të ujit (pagesat kanë filluar në dhjetor të vitit 2015) për këtë apartament.

**25.6.** Duke qenë se ky apartament i është dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 32/4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të z. M. B. për të blerë këtë apartament duke konsideruar: (i) pasuritë e krijuara; (ii) të ardhurat; (iii) shpenzimet familjare të tij. Në rastin e personave të tretë të lidhur, praktika e Kolegjit çmon se *“...në rastet kur subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur<sup>21</sup>.”*

### **Në lidhje me pasuritë e vëllait të subjektit, z. M. B.**

**25.6.1.** Bazuar në shkresën e DPSHTRR-së nr.\*\*\* prot., datë 30.4.2020, rezulton se z. B. ka blerë:

<sup>20</sup> E shprehur edhe në deklaratën e pasurisë të vitit përkatës.

<sup>21</sup> Vendimi i Kolegjit të Posaçëm i Apelimit nr. 15 (JR), datë 17.7.2019.

- (i) automjetin “\*\*\*\*”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 28.5.2004, për shumën 250,000 lekë. Këtë automjet e ka shitur në vitin 2014 me kontratën nr. \*\*\*, datë 2.7.2014, për shumën 100,000 lekë.
- (ii) automjetin “\*\*\*\*” me kontratën nr. \*\*\*, datë 17.6.2014, për shumën 3, 500 euro.

**25.6.2.** Agjencia Shtetërore e Kadastrës informon se z. M. B. rezulton aplikues në procesin e legalizimit, sipas *Formularit A*, \*\*\* prot., Patos Fier dhe është i pajisur me leje legalizimi nr. \*\*\*, datë 7.7.2011 për “godinë banimi 2 kate”, \*\*\*, Bashkia Fier.

**25.6.2.1.** Nga dokumentacioni i administruar rezulton se:

- i. në datën 15.3.2005<sup>22</sup> me *Formularin AS* \*\*\* është bërë vetëdeklarimi për legalizim i objektit “shtëpi banimi”<sup>23</sup> me deklarues z. M. B. dhe z. B. B.;
- ii. bazuar në urdhrin<sup>24</sup> nr. \*\*\*, datë 7.3.2011 të drejtorit rajonal të ALUIZNI-t, Qarku Fier, është urdhëruar regjistrimi në bazën e të dhënave të qarkut Fier të shtetasit B. B. si bashkëposedues i objektit pa leje, të vetëdeklaruar nga z. M. B. me formularin nr. \*\*\*;
- iii. bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 24.1.2011 z. B. B. dhe z. M. B. deklarojnë se janë plotësisht dakord për të qenë si bashkëposedues të objektit “shtëpi banimi 2-katëshe”;
- iv. bazuar në deklaratën noteriale nr. \*\*\* datë 19.09.2006 rezulton se z. B. B. ka blerë në vitin 1999 tokë me sipërfaqe 760 m<sup>2</sup> për vlerën 300,000 lekë. Në datën 8.1.2011 është lidhur dhe kontrata e shitblerjes nr.\*\*\* për blerjen e kësaj pasurie (ku blerës rezultojnë babai i subjektit dhe vëllai i saj), e cila, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020, të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Fier, rezulton e regjistruar me numër \*\*\*, zona kadastrale \*\*\* dhe është në bashkëpronësi të vëllait dhe babait të subjektit;
- v. bazuar në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë vlera e investimit është 9,051,392 lekë<sup>25</sup>;
- vi. në datën 7.7.2011 është lëshuar leja e legalizimit për “godinë banimi 2-katëshe” me sipërfaqe totale ndërtimi 337.6 m<sup>2</sup> (kati I+II).
- vii. kjo pasuri figuron e regjistruar me nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në emër të z. B. B. dhe z. M. B., me datë regjistrimi 1.3.2011.
- viii. nga hetimi rezultoi se kishte një mospërputhje midis sipërfaqes të caktuar në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë (sipërfaqja 319.6 m<sup>2</sup>) dhe sipërfaqes në lejen e legalizimit (337.6 m<sup>2</sup>). Në lidhje me këtë mospërputhje subjekti depozitoi<sup>26</sup> shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2020 të ASHK-së Fier ku sqarohet se:...

*“Nga ish-Drejtoria e ALUIZNI-t Fier është përgatitur Formulari i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale më 25.1.2011 për sipërfaqe: kati përdhe 145.3 m<sup>2</sup> dhe kati i parë 174.3 m<sup>2</sup>, në total 319.6 m<sup>2</sup> ndërtim, e cila është shlyer nga subjektet vetëdeklarues më 27.1.11 në Bankën “Credins”. Ndërkohë, më 28.2.2011 nga ish - Drejtoria e ALUIZNI-t Fier është lëshuar një tjetër formular shtesë i pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, për sipërfaqen prej 18 m<sup>2</sup> ndërtim, e cila është shlyer pranë bankës “Credins” më 28.2.2011. Nga sa më sipër, subjektet posedues z. B. S. B. dhe M. B. B. kanë shlyer në total pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për sipërfaqen prej 337.6 m<sup>2</sup> ndërtesë të pasqyruar në lejen e legalizimit nr. \*\*\*, datë 7.7.2011.”*

- ix. referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020 të Drejtorisë Vendore të ASHK-së Fier, rezulton se babai i subjektit ka shitur shtëpi banimi 1+1, me kontratë nr. \*\*\*, datë

<sup>22</sup> Protokolluar në datën 24.3.2005.

<sup>23</sup> Viti i ndërtimit 1.9.1999, sipërfaqja e ndërtimit 117 m<sup>2</sup>, 2 kate mbi tokë.

<sup>24</sup> Shih dokumentacionin e depozituar nga subjekti me nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>25</sup> 319.6 m<sup>2</sup> \* 28321 lekë/m<sup>2</sup>

<sup>26</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 9.11.2020.

30.1.1998, për shumën 400,000 lekë. Kjo shtëpi rezulton të jetë privatizuar nga babai i subjektit.

- x. në lidhje me ndërtimin e shtëpisë me deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 1.7.2020, z. M. B. deklaron se: *“Prindërit e mi kanë ndërtuar në vitet 1995-1999 me të ardhurat e tyre dhe ndihmën e të afërmeve si krah pune një shtëpi banimi...Për këtë banesë nuk kam investuar asnjë lek ...Në vitin 1995, kur ka filluar ndërtimi unë kam qenë vetëm 20 vjeç, i papunë, pa të ardhura dhe ka qenë koha kur jam larguar nga Shqipëria”*.

**25.6.2.2.** Bazuar në dokumentacionin e mësipërm të administruar nga Komisioni vlerësohet se banesa dykatëshe në bashkëpronësi të babait dhe vëllait të subjektit është ndërtuar dhe ka përfunduar në datën 1.9.1999, sikurse pasqyrohet në formularin e vetëdeklarimit dhe sipas kontratës së blerjes së tokës<sup>27</sup>. Ndërsa, sa i takon deklaratimeve të babait dhe vëllait të subjektit, që z. M. B. nuk ka kontribuar financiarisht në ndërtimin e banesës, ato vlerësohen si jo të bazuara në prova shkresore dhe mbeten në nivel deklarativ.

**25.6.2.3.** Për sa i përket subjektit, në shtator të vitit 1999 ka qenë 21 vjeç dhe nuk ka siguruar të ardhura, kështu që ajo nuk mund të ketë kontribuar në ndërtimin e banesës; gjithashtu, gjatë hetimit administrativ nuk rezulton që subjekti të ketë të drejta reale mbi këtë pasuri.

**25.6.2.4.** Sa më sipër, Komisioni vlerëson të konsiderojë se vëllai i subjektit ka kontribuar financiarisht në ndërtimin e banesës në Patos, me të ardhura të përfituara deri në 1.9.1999, kohë kur ka përfunduar ndërtimi i banesës dykatëshe në Patos. Në këtë mënyrë, Komisioni do t'i konsiderojë si të shpenzuara të gjitha të ardhurat e siguruar nga z. B. deri në këtë moment.

**25.6.2.5.** Për të analizuar mundësitë e z. B. për blerjen e apartamentit në Tiranë, Komisioni merr në konsideratë të ardhurat e ligjshme të provuara me dokumentacion që nga data 1.9.1999, e cila është data e përfundimit të ndërtimit të shtëpisë në Patos dhe do të shtrihet deri në datën 22.1.2015, e cila përkon me pagesën e këstit të fundit të apartamentit në Tiranë.

**25.7.** Për të vërtetuar burimin e ligjshëm të ardhurave të vëllait të saj, gjatë hetimit administrativ<sup>28</sup>, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm në lidhje me të ardhurat e z. M. B.:

- A.** deklaratat vjetore të të ardhurave personale (DVAP)<sup>29</sup>, të depozituara për vitet 1998 - 2005. Në këto deklarata janë pasqyruar të ardhurat për familjen e z. M. B., përbërja familjare e tij, si dhe shpenzimet e qirasë dhe shpenzimet e jetesës.

**A1.** Sipas këtyre dokumenteve rezultojnë këto të ardhura nga puna e z. B.:

- në DVAP/1999 deklarohet se të ardhurat për vitin 1998 janë në shumën 1.358.754 dhrahmi (693,924 lekë);
- në DVAP/2000 deklarohet se të ardhurat për vitin 1999 janë në shumën 1.355.911 dhrahmi (610.129 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 78.841 dhrahmi (31,072 lekë), të paguara gjatë vitit 2000;

<sup>27</sup> Shiko 25.6.2.1 pika (iv).

<sup>28</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 9.11.2020.

<sup>29</sup> DVAP është analoge me deklaratën “DIVA”; ajo është detyrim të dorëzohet në Zyrën e Tatimeve D.O.Y. për çdo shtetas dhe resident në shtetin grek, i cili ka mbushur moshën 18 vjeç dhe përfiton çdo lloj të ardhure në këtë shtet ( <http://www.odigostoupoliti.eu/forologiki-dilosi/> )

- në DVAP/2001 deklarohet se të ardhurat për vitin 2000 janë në shumën 3.663.219 dhrahmi (1,443,690 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 50.420 dhrahmi (18.055 lekë), të paguara gjatë vitit 2001;
- në DVAP/2002 deklarohet se të ardhurat për vitin 2001 janë në shumën 3.619.432 dhrahmi (1,296,119 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 139.18 euro (19,193 lekë), të paguara gjatë vitit 2002;
- në DVAP/2003 deklarohet se të ardhurat për vitin 2002 janë në shumën 8.974 euro (1,237,639 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 271.50 euro (36.286 lekë), të paguara gjatë vitit 2003;
- në DVAP/2004 deklarohet se të ardhurat për vitin 2003 janë në shumën 16.881 euro (2,256,274 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 219.38 euro (27,804 lekë), të paguara gjatë vitit 2004;
- Në DVAP/2005 deklarohet se të ardhurat për vitin 2004 janë në shumën 12.123 euro (1,536,559 lekë) dhe se rimbursimi i taksave dhe tatimeve nga shteti është në shumën 286.60 euro ( 35,120 lekë), të paguara gjatë vitit 2005;
- Në DVAP/2006 deklarohet se të ardhurat për vitin 2005 janë në shumën 12.580 euro (1,541,602 lekë).

**Totali i të ardhurave nga pagat e z. M. B. për të gjitha vitet, sipas DVAP-së është në vlerën 10,615,936 lekë<sup>30</sup> dhe totali i rimbursimeve të tatimeve dhe taksave nga shteti grek është në shumën 167,530 lekë.**

Vitet	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Total
Dhrahmi	1,358,754	1,355,911	3,663,219	3,619,432					
Euro					8,975	16,882	12,124	12,580	
<b>Lekë</b>	<b>693,924</b>	<b>610,129</b>	<b>1,443,690</b>	<b>1,296,119</b>	<b>1,237,639</b>	<b>2,256,274</b>	<b>1,536,559</b>	<b>1,541,602</b>	<b>10,615,936</b>

**B.** Në vijim të dokumenteve të mësipërme, subjekti ka vënë në dispozicion dokumente të tjerë të lëshuara nga IKA<sup>31</sup> – Instituti i Sigurimeve Shoqërore Greke – të cilat, sipas periudhave të ndryshme, tregojnë ditët e punës, të ardhurat nga paga, pagesën e pagës dhuratë dhe pagesën e detyrimeve:

- i. Mandatpagesa mujore të printuara nga IKA, të plotësuara nga punëdhënësi për periudhën prill - nëntor 1998, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet në shumën totale 2,144,501 dhrahmi (1,095,209 lekë). Gjatë vitit 1998, bazuar në këto mandatpagesa, z. B. ka punuar 148 ditë pune;
- ii. Mandatpagesa mujore të printuara nga IKA, të plotësuara nga punëdhënësi për periudhën korrik - dhjetor 1999, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet në shumën totale 2,117,286 dhrahmi (952,731 lekë). Gjatë vitit 1999, z. B., bazuar në këto mandatpagesa, ka punuar 116 ditë pune;
- iii. Mandatpagesa mujore të printuara nga IKA, të plotësuara nga punëdhënësi për periudhën janar - dhjetor 2000, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet në shumën totale 2,855,971 dhrahmi si dhe pagën dhuratë të paguar çdo muaj mbi të ardhurat e mësipërme në shumën 716, 493 dhrahmi;

<sup>30</sup> Kurset e këmbimit të lekut me dhrahminë dhe euron janë marrë nga Banka e Shqipërisë: për dhrahminë kurset mesatare të viteve 1998 -2001, ndërsa për euron kurset e datës 31 dhjetor të viteve përkatës.

<sup>31</sup> Instituti i Sigurimeve Shoqërore të Grekisë, i cili ka të dhënat për të gjithë shtetasit dhe rezidentët që punojnë në Greqi. Sistemi i të dhënave është elektronik vetëm nga viti 2002 e në vijim. Para këtij viti të dhënat janë mbajtur në mënyrë manuale. Kjo pasqyrohet nga dokumentet e lëshuara për periudhat respektive nga i njëjti institucion.

- iv. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 1-rë të vitit 2000, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 386,471 drahmi, për të cilën janë mbajtur detyrimet<sup>32</sup>;
- v. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 2-të të vitit 2000, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 148,983 drahmi, për të cilën janë mbajtur detyrimet;
- vi. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 3-të të vitit 2000, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 235,252 drahmi, për të cilën janë mbajtur detyrimet;

Shuma e dhuratës<sup>33</sup> përgjatë vitit 2000 është në vlerën 770,706 drahmi<sup>34</sup>.

Shuma totale e përfituar nga z. M. B. në vitin 2000 është 4,343,170 drahmi ose 1,711,661 lekë. Gjatë këtij viti, z. B., bazuar në mandatpagesat e IKA-s, ka punuar 222 ditë.

- vii. mandatpagesa mujore të printuara nga IKA, të plotësuara nga punëdhënësi për periudhën janar - gusht 2001, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet në shumën totale 2,650,255 drahmi si dhe pagën dhuratë të paguar çdo muaj mbi të ardhurat e mësipërme në shumën 627, 068 drahmi. Mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 1-rë të vitit 2001, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 185,019 drahmi dhe se janë mbajtur detyrimet;
- viii. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 2-të të vitit 2001, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 211,834 drahmi dhe se janë mbajtur detyrimet;
- ix. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 3-të të vitit 2001, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 235,077 drahmi dhe se janë mbajtur detyrimet;

Shuma e dhuratës përgjatë vitit 2001 është 631,930 drahmi.

Shuma totale e përfituar nga z. M. B. në vitin 2001 është 3,909,253 drahmi ose 1,399,903 lekë. Gjatë këtij viti, z. B. ka punuar 174 ditë.

- x. mandatpagesa mujore nga punëdhënësi për periudhën maj - dhjetor 2002, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet në shumën 9,282 euro;
- xi. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 3-të të vitit 2002, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 779.44 euro;
- xii. gjykim mjeku dhe urdhërpagesë subvencioni, lëshuar nga IKA për periudhën e pamundësisë (*pagesa për raport mjekësor për paaftësi në punë*) 3.6.2002 deri më 14.6.2002, ku shuma e paguar është 273.36 euro;
- xiii. dëshmi punësimi për periudhën maj 2002 - gusht 2004, lëshuar nga Dega e ISSH-së, Markopolus;

Shuma totale e përfituar nga z. M. B. në vitin 2002 është 10,335 euro ose 1,425,248 lekë.

- xiv. vërtetim punëdhënësi për periudhën e punësimit 1.1.2003 - 30.11.2003, lëshuar nga IKA, Dega Markopolus.
- xv. gjendja e punësimit për ndërtues periudha qershor – korrik 2003, lëshuar nga IKA, Dega Markopolus, ku deklarohet se të ardhurat e z. B. në total për këtë periudhë kanë qenë 4.301,3 euro.

<sup>32</sup> Në rastin e pagës dhuratë detyrimet përbëhen vetëm nga TAP-i dhe jo nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

<sup>33</sup> Dhuratat, pagesat e të cilave vërtetohen nga IKA çdo 4-mujor, përfaqësojnë rrogën e 13-të dhe 14-të, të cilat për periudhën në fjalë, janë të përfituara me ligj në Greqi. Shih ligji nr. 1901/1951, i ndryshuar me ligjin 1.082/80, neni 1; i ndryshuar me ligjin nr 2084/92 ([https://www.ethnos.gr/oikonomia/11836\\_doro-hristoygennon-o-13os-misthos-ehei-ti-diki-toy-syndikalistiki-istoria](https://www.ethnos.gr/oikonomia/11836_doro-hristoygennon-o-13os-misthos-ehei-ti-diki-toy-syndikalistiki-istoria))

<sup>34</sup> Kjo shumë është sa 2 paga mujore dhe përfaqëson pagën e 13-të dhe të 14-të.

- xvi. mandatpagesa mujore nga punëdhënësi për periudhën janar – dhjetor 2003, ku vërtetohet se z. B. ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet, në shumën 20,939 euro.
- xvii. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 1-rë të vitit 2003, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,104.10 euro.
- xviii. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 2-të të vitit 2003, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,005.29 euro.
- xix. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 3-të të vitit 2003 lëshuar nga IKA, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,724.33 euro. Shuma e dhuratës përgjatë vitit 2003 është 3,834 euro.
- Shuma totale e përfituar nga z. M. B. në vitin 2003 është 24,773 euro ose 3,310,889 lekë.
- xx. mandatpagesa mujore nga punëdhënësi për periudhën janar - gusht 2004, ku vërtetohet se z. B.ka përfituar të ardhura, për të cilat janë paguar detyrimet, në shumën 12,568 euro. Në mandatpagesën e muajit korrik 2004 rezulton se është përfituar përveç pagës mujore edhe shuma 247 euro si shumë e prapambetur<sup>35</sup>. Kjo vlerë është shtuar në të ardhurat e vitit 2004.
- xxi. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 1-rë të vitit 2004, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,490.40 euro.
- xxii. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron dhuratën për katërmujorin e 2-të të vitit 2004, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,184.93 euro.
- xxiii. mandatpagesë, lëshuar nga IKA, e cila pasqyron pagën dhuratë për katërmujorin e 3-të të vitit 2004, nga ku rezulton se z. B. ka përfituar shumën 1,346.02 euro. Shuma e dhuratës përgjatë vitit 2004 është 4,021 euro.
- xxiv. Mandatlikuidimi, nëpërmjet të cilit z. B.deklaroi se ka marrë shumën 745.15 euro si likuidim i dëmshpërblimit të tij për shkak të kallëzimit të kontratës. Shuma totale e përfituar nga z. M. B. në vitin 2004 është 17,582 euro ose 2,228,281 lekë.
- xxv. Për vitin 2005 vëllai i subjektit nuk ka paraqitur vërtetim nga IKA, kështu që të ardhurat e tij për këtë vit janë ato të deklaruara në DVAP/2006.

**Totali i të ardhurave nga pagat e z. M. B. për të gjitha vitet, sipas dokumenteve të IKA-s, të vëna në dispozicion nga subjekti, është në vlerën 13,665,525 lekë<sup>36</sup>.**

Tabelë përmbledhëse sipas të ardhurave të trajtuara në seksionin B

Vitet	1998	1999	2000	2001	2002	2003	2004	2005	Total
Dhrahmi	2,144,501	2,117,286	4,343,170	3,909,253					
Euro					10,335	24,773	17,582	12,580	
Lekë	<b>1,095,209</b>	<b>952,731</b>	<b>1,711,661</b>	<b>1,399,903</b>	<b>1,425,248</b>	<b>3,310,889</b>	<b>2,228,281</b>	<b>1,541,602</b>	<b>13,665,525</b>

C. Në mbështetje të dokumentacionit të mësipërm trajtuar në seksionin B, të ruajtura nga z. M. B. ndër vite, vëllai i subjektit është drejtuar pranë IKA-s dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dy dokumente të lëshuara së afërmi nga ky institucion dhe pikërisht:

<sup>35</sup> Shumat e prapambetura përfaqësojnë vlerat e akumuluar nga momenti kur rritet paga deri në momentin e pagesës së kësaj rritjeje page.

<sup>36</sup> Kurset e këmbimit të lekut me dhrahminë dhe euron janë marrë nga Banka e Shqipërisë: për dhrahminë kurset mesatare të viteve 1998 -2001, ndërsa për euron kurset e datës 31 dhjetor të viteve përkatës.



**C.1.** Printim i llogarisë/*statement* i të sigurvearit M. B., duke filluar nga janar 2002<sup>37</sup>, lëshuar nga Fondi i Bashkuar i Sigurimeve Shoqërore të Greqisë (EFIA).

Në këtë dokument janë pasqyruar të ardhurat nga paga, për të cilat janë paguar detyrimet e z. M. B. për periudhën maj 2002 deri gusht 2004.

Sipas këtij dokumenti **z. B. ka përfituar nga pagat në total për këtë periudhë, shumën 50, 444 euro.**

**C.2.** Shkresë nr. 5479/20, datë 11.8.2020, nga Fondi i Bashkuar i Sigurimeve Shoqërore të Greqisë “EIFA”, në përgjigje të shkresës nr. 5479/21-07-2020, drejtuar këtij institucioni nga z. B.. Në përgjigjen e kësaj shkrese thuhet se “*Për sigurimin që ekziston nga “Rregullorja e sigurimit të projekteve teknike nëpërmjet sistemeve elektronike” që vlen deri më 31.12.2001 (Neni 1, par.3 dhe 15 i ligjit nr. 325/78 A.Y.K.Y B1/21.212138/79), për periudhat kohore (vitet) që deklaroni mungesë të ekstrakteve personale të llogarive/statement sigurve, janë regjistruar 834 ditë sigurimi, dega “Sigurime të rënda ndërtimi”, të cilat analizohen si më poshtë.*

**C.2.1.** Sipas kësaj shkrese ditët e punës për çdo vit janë pasqyruar në tabelën më poshtë:

Viti	Ditë për të cilat janë paguar siguracione	Ditët e rritjes së pagës	Totali
1998	161	30	191
1999	127	24	151
2000	243	45	288
2001	172	32	204
<b>Total</b>	<b>703</b>	<b>131</b>	<b>834</b>

**C.2.2.** Nga analiza e kësaj shkrese rezulton se:

i. M. B. i është drejtuar këtij institucioni (EIFA), pasi ka qenë i bindur se ai ka punuar më shumë ditë, sesa ka ruajtur të dokumentuara nga IKA;

ii. ditët e sigurimit<sup>38</sup> në total janë 834 dhe janë të përbëra nga ditët e sigurimit plus ditët e rritjes së pagës.

**C.2.3.** Subjekti ka depozituar dhe dokumentet e mëposhtme:

i. vërtetim nr. 2697, datë 21.8.2020 i OAED (Organizata e Punësimit të Fuqisë Punëtore të Greqisë), nga ku rezulton se z. B. është subvencionuar për shkak papunësie, pra, është paguar me ndihmë sociale për periudhat:

a. 8.10.2001 - 15.5.2002 me 182 ditë.

b. 19.8.2004 - 18.8.2005 me 300 ditë.

ii. vërtetim, nr. 4799 i OAED –së, nga ku rezulton se z. B. është subvencionuar për shkak papunësie prej datës 19.8.2004 - 18.8.2005;

iii. kontratë qiraje banese, datë 15.3.2000;

iv. kopje të pasaportës së z. M. B. nga ku rezulton se ai ka hyrje - dalje nga viti 1997 e në vijim dhe specifikisht nga vlatat kufitare dallohet viza 1-vjeçare, datë 26.3.1997, e cila është zgjatuar pas mbarimit të saj deri në dhjetor 2003.

<sup>37</sup> Datë kur të dhënat e personave të sigurvear pranë IKA-s janë mbajtur në sistem elektronik.

<sup>38</sup> Këtu ka kuptimin e ditëve të punës, për të cilat punonjësi ka punuar duke qenë i sigurvear, domethënë për to/ditët janë paguar të gjitha detyrimet ndaj shtetit.

- v. deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 13.10.2020, të z. B. B., babai i subjektit, i cili deklaroi se banesën në Patos e ka ndërtuar me të ardhurat e tij dhe të bashkëshortes së tij nga puna e kryer në shtet dhe privatisht...Kjo banesë është ende e papërfunduar... Në vitin 2000 djali i tij M. B. ka sjellë vajzën D. në Shqipëri dhe e ka mbajtur ai. Në dhjetor të vitit 2003 kanë ardhur të jetojnë nusja e djalit të tij, A., e cila ishte 6-muajshe shtatzënë me dy djem binjakë që lindën në mars të vitit 2004. Deri në fillim të vitit 2005, kur djali i tij është kthyer nga Greqia në Shqipëri shpenzimet e jetesës për bashkëshorten dhe fëmijët e tij janë mbuluar nga ai (z. B. B.)...Në prill të vitit 2015 ka përfituar një shumë prej 1,026,340 lekë, të cilat i ka tërhequr me dy këste e çek nga llogaria e përmbaruesit në datat 16.04.2015 dhe 05.05.2015...këtë shumë ia dha djalit të tij për mobilimin e apartamentit në Tiranë.”

Bashkëlidhur deklaratës është vendosur nxjerrja e llogarisë e përmbaruesit z. N. Ç. nga ku rezultoi se z. B. B. ka tërhequr në dy këste: në datën 16.4.2015 shumën 557,040 lekë dhe në datën 5.5.2015 shumën 469,300 lekë. Shuma 1,026,340 lekë do të përfshihet në të ardhurat e z. M. B. për vitin 2015.

- vi. deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 1.7.2020 e z. M. B., i cili deklaroi se:  
“Prindërit e tij kanë ndërtuar në vitet 1995-1999 me të ardhurat e tyre dhe ndihmën e të afërmeve si krah pune një shtëpi banimi...Për këtë banesë nuk ka investuar asnjë lek ...Në vitin 1995, kur ka filluar ndërtimi ai ka qenë vetëm 20 vjeç, i papunë, pa të ardhura dhe ka qenë koha kur është larguar nga Shqipëria.”;

- vii. deklaratë noteriale, nr. \*\*\*, datë 12.5.2020 të z. M. B., i cili deklaroi se ka emigruar disa herë nga viti 1992 - 1993 me vajtje - ardhje dhe në fund të vitit 1994 ka qëndruar pa shpërngulje në Greqi...Nga janari i vitit 1995 deri në dhjetor 1997 ka punuar i paregjistruar ... me të ardhura 12000 dhrama në ditë... të ardhurat e tij për këto 3 vite, për të cilat nuk ka qenë i deklaruar dhe nuk ka paguar detyrime tatimore janë 10 milion dhrahmi...;

- viii. deklaratë noteriale, nr. 5668/1457, datë 13.10.2020 të znj. A. B., e cila deklaroi se në gusht të vitit 1999 është martuar me z. M. B.. Nga dhjetori i vitit 1999 së bashku me bashkëshortin ka punuar në Greqi deri në janar 2004 kur është kthyer, ndërsa vëllai i subjektit ka ndënjur deri në fillim të vitit 2005... Ajo së bashku me bashkëshortin kanë jetuar në një banesë modeste, që e paguanin me qira minimale...Bashkëshortja e pronarit të bashkëshortit ishte me origjinë shqiptare, A. K.. Tek ajo kryente të gjitha punët e shtëpisë: merrej me gatimin, pazarin dhe paguhej deri në vitin 2002 me 20.000 - 25.000 dhrahmi në ditë dhe pas kësaj periudhe kur pagesa bëhej në euro, në shumën 70 - 80 euro në ditë. Brenda ditës punonte dhe në një apo dy shtëpi të tjera...

- ix. deklaratë noteriale nr. \*\*\*, datë 05.10.2020 të znj. A. K., e cila deklaroi se ka jetuar në Greqi nga viti 1995 dhe në vijim. Në vitet 1995-2000 ka bashkëjetuar me bashkëshortin e saj z. A. A., shtetas grek. Në dhjetor të vitit 2000 ka lidhur martesë ligjore dhe ka vazhduar të jetojë në Athinë deri në vitin 2004. Nga viti 1995 - 1999 z. M. B. ka punuar tek ata në shërbime të ndryshme për shtëpinë dhe bizneset dhe ata e paguanin 200,000 dhrahmi në muaj, i mbulonin të gjitha shpenzimet për ushqim, veshmbathje etj. Puna tek ata ishte me orar të kufizuar dhe kujton që ai punonte ndërkohë edhe në ndërtim në disa biznese që ia kishte gjetur bashkëshorti i saj. Gjithashtu i kanë dhënë dhurata gjatë periudhës së Krishtlindjeve dy rroga mujore dhe për Pashkë një rrogë e gjysmë mujore....Rreth vitit 1999 z. B. martohet dhe së bashku me bashkëshorten kanë jetuar në shtëpi me qira. Bashkëshortja e z. B. ka punuar tek ata dhe është paguar për periudhën 1999 - 2000 në shumën 20.000 - 25.000 dhrahmi

*dita, ndërsa deri në vitin 2004 në shumën 70 - 80 euro dita. Ndërkohë ajo bënte punë shtëpie edhe në disa shtëpi e zyra të tjera, ku, në dijeninë e saj pagesat ishin pothuaj të njëjta. M. B., pasi iu largua bashkëshortja në vitin 2004, ka jetuar me ta pa asnjë shpenzim. Përgjatë kësaj periudhe ai ka punuar në punë të ndryshme dhe paguhej 1200 - 1400 euro.*

**25.7.1.** Bazuar në të gjithë dokumentacionin e mësipërm, të vënë në dispozicion nga subjekti duke përfshirë: (i) të ardhurat vjetore të deklaruara në deklaratat vjetore të të ardhurave personale për vitet 1998 – 2005; (ii) të ardhurat e përllogaritura nga mbledhja e të gjithë dokumentacionit mujor për të ardhurat, ditët e punës dhe dhuratat me bazë 4-mujore të paguara nga IKA, dokumente të cilat janë ruajtur nga vëllai i subjektit për vitet 1998 - 2004; (iii) ditët e punës të plota të njoftuara nga Fondi i Bashkuar i Sigurimeve Shoqërore të Greqisë EIFA për vitet 1998-2001, rezulton se:

- të gjitha dokumentet e mësipërme, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë informojnë mbi të ardhura, për të cilat janë paguar të gjitha detyrimet në shtetin grek, duke i bërë këto të ardhura të ligjshme;
- të ardhurat e vëllait të subjektit sipas dokumenteve nga IKA<sup>39</sup> janë në vlerë më të lartë se ato të deklaruara prej tij në DVAP-të vjetore.
- ditët e punës të konfirmuara nga Fondi i Bashkuar i Sigurimeve Shoqërore të Greqisë EIFA rezultojnë të jenë më të larta sesa shumatorja e ditëve të punës, të pasqyruara në dokumentet e IKA-s, të mbledhura dhe ruajtura nga vëllai i subjektit ndër vite.
- në analizën financiare do të merren parasysh si ditë pune, ato të konfirmuara nga EIFA, duke aplikuar për këto ditë pagën mesatare ditore të nxjerrë nga mandatpagesat mujore të IKA-ve të ruajtuara nga vëllai i subjektit.

## **25.7.2. Analiza Financiare**

Analiza financiare për aftësinë paguese të vëllait për blerjen e apartamentit, i cili është në përdorim të subjektit, është kryer duke konsideruar këto elemente:

- i. metodologjia e përdorur është ajo kumulative, pasi vëllai i subjektit nuk është subjekt i deklaramit periodik të pasurisë;
- ii. viti i fillimit të analizës është 1.9.1999, si datë e konsideruar për përfundimin e ndërtimit të banesës në Patos, analizuar në pikën 25.6.2;
- iii. analiza vazhdon deri në 22.1.2015, datë e cila përkon me pagesën e kështit të fundit të paguar për blerjen e apartamentit nga vëllai i subjektit;
- iv. për kurset e këmbimit nga dhrahmi dhe euro në lekë janë përdorur kurset mesatare të marra nga Banka e Shqipërisë për vitet përkatëse;
- v. tek të ardhurat *nuk janë përfshirë* ato nga emigracioni të deklaruara nga vëllai i subjektit gjatë viteve 1992 deri 1997, të ardhura e bashkëshortes së vëllait, derisa subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion përfitimin dhe ligjshmërinë e këtyre të ardhurave. Subjekti ka pretenduar se këto të ardhura të vëllait të saj janë afërsisht në shumën 10 milion dhrahmi;

---

<sup>39</sup> Mandatpagesa mujore të paraprintuara nga IKA dhe të plotësuara nga punëdhënësi për të ardhurat e përfituara nga M. B., për të cilat janë paguar detyrimet; mandatpagesa të lëshuara nga IKA, ku pasqyrohen *dhuratat* për çdo 4-mujor të viteve 2000-2004.

- vi. janë llogaritur shpenzimet e jetesës, të cilat janë marrë në bazë të përbërjes familjare dhe ku kanë jetuar vëllai dhe familja e tij,<sup>40</sup> sipas të dhënave përkatëse për Greqinë<sup>41</sup> dhe Shqipërinë<sup>42</sup>;
- vii. janë llogaritur blerjet e dy automjeteve në vitin 2004 dhe 2014, të cilat janë konsideruar si shpenzim;
- viii. likuiditetet nga gjendjet e llogarive në sistemin bankar vendas.

Në analizën financiare janë përfshirë:

**A.** të ardhurat e përfituara në shtetin grek nga 1.9.1999 deri në vitin 2005, pasi subjekti ka arritur të provojë me dokumentacion provues të shtetit grek këto të ardhura dhe specifikisht:

1. për periudhën 1.9.1999 deri 30.12.2001, të ardhurat mbi të cilat janë paguar detyrimet janë përlllogaritur sipas ditëve të punës të siguruara<sup>43</sup>, duke llogaritur mbi këto ditë pagën mesatare ditore për çdo vit përkatës, të pasqyruar nga mandatpagesat e IKA-s.
2. ditët e punës janë marrë nga shkresa e depozituar nga subjekti<sup>44</sup>, lëshuar nga Fondi i Bashkuar i Sigurimeve Shoqërore me nr. \*\*\*, datë 11.8.2020, nga ku rezulton se për z. M. B. janë regjistruar 834 ditë sigurimi për periudhën 1998 -2001, të pasqyruara në tabelën me poshtë.

<i>Vitet</i>	<i>1998</i>	<i>1999</i>	<i>2000</i>	<i>2001</i>
Ditë sigurimi	161	127	243	172
Ditet e rritjes së pagës	30	24	45	32
Totali i ditëve	191	151	288	204

**A.1.** Më specifikisht:

- a) Për vitin 1999 janë konsideruar pagat dhe *pagesat dhuratë* duke filluar nga 1 shtatori<sup>45</sup> deri më 31 dhjetor 1999, sipas mandatpagesave të printuara nga IKA dhe të plotësuara nga punëdhënësi;
- b) Në vitin 2000 është shtuar shuma 1,291,213 dhrahmi<sup>46</sup>, që i përket 66 ditë pune shtesë, bazuar në pagën mesatare ditore të këtij viti;
- c) Në vitin 2001 është përfshirë shuma 988,244 dhrahmi<sup>47</sup> për periudhën 8.10.2001 – 15.5.2002, të cilat janë të ardhura të përfituara nga pagesa e asistencës sociale sipas shkresës së OAED-së<sup>48</sup>. Meqenëse në këtë shkresë nuk pasqyrohen shumat e përfituara

<sup>40</sup> 1998 deri korrik 2000 për 2 persona në Greqi, gusht - dhjetor 3 persona në Greqi; 2001-2003 çifti ka jetuar në Greqi dhe vajza, e cila ka lindur po aty më 2.8.2000, është rritur me gjyshërit në Patos (sipas deklaramit të subjektit); Në vitin 2004 bashkëshortja me vajzën dhe 2 binjakët, të cilët kanë lindur në Shqipëri më 6.3.2004, jetojnë në Shqipëri dhe M. B. në Greqi; në vitin 2005 e gjithë familja është zhvendosur dhe jeton në Patos.

<sup>41</sup> Sipas të dhënave të Shërbimit Statistikor Grek (<https://www.statistics.gr/el/statistics/-/publication/SFA10/>)

<sup>42</sup> Sipas standardit të ILDKPKI-së.

<sup>43</sup> Shih shkresën nr. \*\*\*, datë 11.8.2020 nga EFIA (Fondi i Bashkuar i Sigurimit Shoqëror).

<sup>44</sup> Shih përgjigjen e pyetësorit të datës 9.11.2020.

<sup>45</sup> Konsideruar nga Komisioni si kohë në të cilën është ndërtuar banesa në Patos.

<sup>46</sup> Paga mesatare ditore është llogaritur nga të ardhurat vjetore 4,343,170 DPX :222 ditë pune = 19,563.83 dhrahmi dita x 66 ditë = 1,291,213 DPX.

<sup>47</sup> 12,580 euro:300 ditë = 41.93 eur/ditë x 182 ditë = 7,632 euro për periudhën 08.10.2001deri 15.05.2002. Bazuar në muajt e shtrirjes së kësaj pagese, 38% është përfituar gjatë vitit 2001 dhe 62% gjatë vitit 2002. Kursi Eur: DPX është marrë 340.75.

<sup>48</sup> Vërtetim nr. 2697 datë 21.08.2020 i OAED (Organizata e Punësimit të Fuqisë Punëtore të Greqisë) nga ku rezulton se z. B. është paguar me asistencë sociale për periudhat 8.10.2001 - 15.5.2002 me 182 ditë dhe 19.8.2004 - 18.8.2005 me 300 ditë. OAED-ja është institucioni përgjegjës për mbajtjen e të dhënave të personave të punësuar në shtetin grek në lidhje me pagesat e asistencave sociale dhe të paaftësisë së përhershme/përkohshme në punë;

nga M. B., Komisioni ka kryer përllogaritjet, duke iu referuar vlerës së subvencionimit për periudhën 2004 - 2005, e cila është në shumën 12,580 euro për 30 ditë.

**A.2.** Gjithashtu, për këtë vit, është shtuar shuma 844,396 dhrahmi<sup>49</sup>, që i përket 30 ditë pune shtesë, bazuar në pagën mesatare ditore të këtij viti.

- a) Për periudhën 2002-2004, të ardhurat mbi të cilat janë paguar detyrimet janë përllogaritur si shumatore e pagesave mujore të marra nga ekstrakti i llogarisë së të siguruarit<sup>50</sup>;
- b) Për vitin 2002 është shtuar shuma 4,732 euro, e cila përfaqëson pjesën takuese të asistencës sociale, sikurse trajtuar në pikën A.1/c më lart;
- c) Për vitin 2005, të ardhurat do të konsiderohen ato të deklaruara në DVAP/2006, si i vetmi dokument i vënë në dispozicion nga subjekti për vitin 2005.

➤ **Sa më sipër, të ardhurat e vëllait të subjektit si emigrant në Greqi për periudhën 1.9.1999 deri në 2005 janë në shumën 14,145,668 lekë.**

**A.3.** Në bazë të legjislacionit grek<sup>51</sup> për çdo individ, i cili krijon të ardhura të ligjshme në Greqi, zbatohet mbajtja nga paga për sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe TAP-in. Sipas këtij legjislacioni “...janë punëdhënësit ata që kanë detyrimin e mbajtjes në burim të ndalesave ndaj pagave të punonjësve të tyre gjatë procesit të pagave. Këto detyrime përfshijnë tatimin mbi të ardhurat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat duhet të mbahen në burim në çdo cikël pagese dhe t'i paguhen autoritetit përkatës<sup>52</sup>, mbajtje të cilat bëhen nga punëdhënësi çdo muaj”.

<i>Të ardhurat sipas dok. IKA</i>	<i>sht.99</i>	<i>2000</i>	<i>2 001</i>	<i>2002</i>	<i>2003</i>	<i>2004</i>	<i>2005</i>	<i>Total</i>
Në monedhën origjinale	GRD 1 578 800	GRD 5 634 383	GRD 5 741 893	€ 15 067	€ 24 773	€ 17 582	€ 12 580	
Në lekë	710 424	2 220 534	2 056 172	2 077 787	3 310 889	2 228 281	1 541 602	<b>14 145 688</b>

**B.** Të ardhurat e pasqyruara nga puna në Shqipëri nga shkurt 2005 e në vijim:

1. Të ardhurat nga puna me taksi nga shkurt 2005 deri qershor 2011 janë llogaritur duke u bazuar në:
  - dokumentacionin e administruar për kategorinë e biznesit, e cila është ajo e qarkullimit deri 2 milion lekë në vit<sup>53</sup>;

pagesat e çdo lloj subvencionit të shtetasve dhe rezidentëve sipas ligjeve në fuqi; përgjegjës për lëshimin e lejes së punës së shtetasve jashtë BE-së që punojnë në Greqi.

<sup>49</sup> Paga mesatare ditore është llogaritur nga të ardhurat vjetore 4,897,497 DPX 174 ditë pune = 28,146.53 dhrahmi dita x 30 ditë = 844,396 DPX.

<sup>50</sup> Shih shkresën “Llogaria e të siguruarit”, datë 10.7.2020 nga EFIA-ja, Dega Koropi, Athinë.

<sup>51</sup> Greqia është anëtare e BE-së qysh në vitin 1981. Me ratifikimin e Traktatit të Maastricht-it 7.2.1992 dhe firmosjen e tij edhe nga Greqia, ajo ka detyrimin të zbatojë direktivat e BE-së dhe të përshtasë legjislacionin e saj drejt atij të BE.

<sup>52</sup> <https://www.activpayroll.com/global-insights/greece>

<sup>53</sup> Shërbim “taksi”, me NIPT \*\*\*, regjistruar si biznes i vogël, datë 2.2.2005 dhe mbyllur aktiviteti më 30.6.2011. Sipas shkresës së Bashkisë Patos datë 27.12.2018 vërtetohet se M. B. ka qenë i regjistruar në Bashkinë Patos për periudhën shkurt 2005 - qershor 2011; ka deklaruar xhiro deri 2 milion lekë për çdo vit kalendarik, ka paguar taksat dhe tatimet vendore dhe nuk ka detyrime ndaj Bashkisë Patos.

- të dhënat<sup>54</sup> mbi shpenzimet operacionale të një taksie, masën e tatimeve për këtë lloj aktiviteti;
- pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- pagesat e tatimeve dhe taksave vendore për periudhën<sup>55</sup>.

Të dhënat (në lekë) e cituara si më lart paraqiten në tabelën e mëposhtme.

<i>Vitet</i>	<i>Xhiro vjetore</i>	<i>Shpenzimet</i>	<i>Fitimi</i>
2 005	<i>deri 2 000 000</i>	786 991	1 213 009
2 006	2 000 000	712 400	1 287 600
2 007	2 000 000	704 900	1 295 100
2 008	2 000 000	708 500	1 291 500
2 009	2 000 000	726 100	1 273 900
2 010	2 000 000	690 170	1 309 830
2 011	1 000 000	369 196	630 804
<b>Total</b>	<b>13 000</b>	<b>4 698</b>	<b>8 301 743</b>

**Në total llogaritet shuma neto prej 8, 301, 743 lekë.**

Të ardhura nga paga, nga korrik 2011 deri në fund të periudhës së analizuar<sup>56</sup>, në total shuma 2,595,964 lekë. Interesa të përfituara nga bankat<sup>57</sup>, në total shuma 163,938 lekë.

<sup>54</sup> Me përgjigjet e pyetësorit të datës 26.6.2020, subjekti ka venë në dispozicion të Komisionit shkresat: Kthim përgjigjeje nga Sindikata Shqiptare e Taksive, datë 1.7.2020; Shkresë e ISSH-së Fier, nr. \*\*\*, datë 1.7.2020.

<sup>55</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020, nga Bashkia Patos.

<sup>56</sup> Kontratë pune me punëdhënësin “\*\*\*\*” Ltd, datë 11.6.2011; Shkresa e bankës “Intesa San Paolo” nr. \*\*\*, datë 6.5.2020; Shkresë e ISSH-së nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020, Shkresa e “Raiffeisen Bank” nr. \*\*\*, datë 28.4.2020.

<sup>57</sup> Nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank”.

*Analiza financiare mbi mundësinë e blerjes së apartamentit nga vëllai i subjektit – në lekë*

<b>Huadhënësi</b>	<i>sht.99</i>	<b>2000</b>	<b>2001</b>	<b>2002</b>	<b>2003</b>	<b>2004</b>	<b>2005</b>	<b>2006</b>	<b>2007</b>
<b>Të ardhurat</b>									
	<b>710 424</b>	<b>2 220 534</b>	<b>2 056 172</b>	<b>2 077 787</b>	<b>3 310 889</b>	<b>2 302 231</b>	<b>2 946 370</b>	<b>1 300 625</b>	<b>1 317 811</b>
Të ardhura nga paga Greqi (lekë)	710 424	2 220 534	2 056 172	2 077 787	3 310 889	2 228 281	1 541 602		
Të ardhura nga shteti grek për fëmijët						69 740	169 693		
Të ardhura nga puna me taksi							1 213 009	1 287 600	1 295 100
Paga tek “****” Ltd									
Interesa nga Bankat						4 210	22 065	13 025	22 711
<b>Shpenzimet</b>	<b>144 063</b>	<b>553 575</b>	<b>646 672</b>	<b>736 379</b>	<b>759 274</b>	<b>1 705 397</b>	<b>839 966</b>	<b>547 047</b>	<b>685 728</b>
Shpenzimet e jetesës	144 063	553 575	646 672	736 379	759 274	1 047 578	547 785	547 785	683 100
Makinë “****”						250 000			
Ndryshim likuiditetesh						407 819	292 181	-738	2 628
Mundësia për kursime	566 361	1 666 959	1 409 500	1 341 408	2 551 615	596 834	2 106 403	753 578	632 083
<b>Mundësia për kursime kumulative</b>	<b>566 361</b>	<b>2 233 320</b>	<b>3 642 820</b>	<b>4 984 228</b>	<b>7 535 843</b>	<b>8 132 677</b>	<b>10 239 080</b>	<b>10 992 658</b>	<b>11 624 741</b>

<b>Huadhënësi</b>	<b>2008</b>	<b>2009</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>22.1.2015</b>	<b>Total</b>
<b>Të ardhurat</b>	<b>1 319 945</b>	<b>1 296 878</b>	<b>1 324 070</b>	<b>1 026 171</b>	<b>720 628</b>	<b>675 708</b>	<b>870 873</b>	<b>69 652</b>	<b>25 546 767</b>
Të ardhura nga paga në Greqi lekë									14 145 688
Të ardhura nga shteti grek për fëmijët									239 433
Të ardhura nga puna me taksi	1 291 500	1 273 900	1 309 830	630 804					8 301 743
Paga tek “****” Ltd				383 542	717 038	75 708	750 024	69 652	2 595 964
Interesa nga Bankat	28 445	22 978	14 240	11 825	3 590		20 849		163 938
Shitur pasuri							100 000		100 000
<b>Shpenzimet</b>	<b>581 219</b>	<b>583 156</b>	<b>683 176</b>	<b>606 219</b>	<b>9 529 375</b>	<b>4 252 438</b>	<b>1 495 857</b>	<b>682 532</b>	<b>25 032 073</b>
Paguar apartamenti në Tiranë					8 383 200	3 505 250		594 648	12 483 098
Shpenzimet e jetesës	683 100	683 100	683 100	683 100	697 740	705 120	1 099 990	93 448	10 994 909
Makinë “****”							490 385		740 385
Ndryshim likuiditetesh	-101 881	-99 944	76	-99 510	448 435	42 068	-94 518	-5 565	791 052
Paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë				22 629					22 629
Mundësia për kursime	738 726	713 722	640 893	419 952	-8 808 746	-3 576 730	-624 984	-612 880	<b>514 694</b>
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>12 363 467</b>	<b>13 077 190</b>	<b>13 718 083</b>	<b>14 138 035</b>	<b>5 329 289</b>	<b>1 752 558</b>	<b>1 127 574</b>	<b>514 694</b>	



Nga analiza financiare e mësipërme rezulton se vëllai i subjektit ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e apartamentit dhe mobilimin e tij<sup>58</sup>.

**25.7.3.** Në përfundim të analizimit të të gjithë dokumentacionit të depozituar nga subjekti në formën e kërkuar nga ligji, por edhe në origjinal, pas kërkesës së bërë nga Komisioni, trupi gjykues konstaton si më poshtë:

- (i) të ardhurat e z. M. B., për të cilat provohet se janë paguar sigurimet shoqërore dhe gjithë detyrimet tatimore sipas dokumentacionin të depozituar nga subjekti për periudhën shtator 1999- 2005 janë në shumën 14,145,688 lekë.
- (ii) të ardhurat e siguruara në Shqipëri për vitet 2005 - 2015 janë në shumën 11,161,645 lekë.
- (iii) vlera e apartamentit e paguar deri në vitin 2015 është 12,483,098 lekë.
- (iv) shpenzimet e jetesës për periudhën 1999-2015 janë në vlerën 12,548,975 lekë.

Trupi gjykues mban në vëmendje gjithashtu edhe faktin e pretenduar, por të paprovuar nga subjekti për të ardhura të krijuara edhe nga bashkëshortja e z. B., gjatë periudhës së qëndrimit në Greqi. Këto të ardhura, gjithsesi, nuk janë përfshirë në analizën financiare.

**25.7.4.** Në vlerësim të këtyre fakteve rezulton se vëllai i subjektit, zoti M. B., ka patur të ardhura me burim të ligjshëm për blerjen e apartamentit. Të ardhurat e provuara nëpërmjet dokumentacionit të administruar nga IKA janë të ardhura që provohet se janë përfituar prej tij dhe se janë paguar detyrimet tatimore, përfshirë edhe sigurimet shoqërore.

**Në përfundim të hetimit dhe analizës për këtë pasuri në përdorim të subjektit, Komisioni çmon se është provuar aftësia blerëse, me burim të ligjshëm, e apartamentit nga vëllai i subjektit, zoti M. B..**

**26. Automjet<sup>59</sup>,** në pronësi të bashkëshortit V. M. (në përdorim të subjektit) e llojit “autoveturë”, marka “\*\*\*\*”, e blerë më 11.8.2005. Ky automjet ka dalë nga qarkullimi për shkak të vjetërsisë së tij (viti i prodhimit 1995) më 10.10.2016. Vlera e automjetit 250,000 lekë. Pjesa takuese 50%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** të ardhurat nga paga si magjistrate në shkollën e Magjistraturës, Tiranë dhe e bashkëshortit si specializant në spitalin universitar të sëmundjeve të mushkërive “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.

### **Hetimi<sup>60</sup>/ analiza ligjore – financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**26.1.** Në datën 11.8.2005 me kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*, bashkëshorti i subjektit ka blerë në shumën 250, 000 lekë automjetin tip “\*\*\*\*” me targë AC 077HB. Ky automjet është deklaruar dhe në DVP/2005. Bazuar në vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 24.1.2017 të DRSHTRR-së Fier rezulton se mjete me targa \*\*\* ka qenë i regjistruar në emër të z.V. M. dhe ka dalë nga qarkullimi në datën 10.10.2016.

<sup>58</sup> Deklaruar në shumën 700,000 lekë.

<sup>59</sup> Subjekti ka dorëzuar: (i) vërtetim çregjistrimi nga DRSHTRR-ja Fier nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2017; (ii) kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.8.2005; (iii) vërtetim çregjistrimi nga DRSHTRR-ja Fier nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2016; (iv) pagesa të detyrimeve vjetore të automjetit me targa \*\*\*.

<sup>60</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, Kthim përgjigjeje DPSHTRR-ja, nr. \*\*\* prot., datë 1.10.2019.

## 26.2. Analiza financiare

	11.8.2005
<b>Pasuri</b>	<b>465 064</b>
Makinë “****” targa ***	250 000
Shtesa/pakësime, likuiditete	215 064
Likuiditete gjendje	215 345
<b>Të ardhura, dokumentuar</b>	<b>732 919</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	600 117
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	132 803
<b>Shpenzime</b>	<b>199 904</b>
Shpenzime jetese	199 904
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>67 951</b>

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

**26.3.** Pas analizimit të dokumentacionit dhe kryerjes së analizës financiare, trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë paqartësi apo pamjaftueshmëri mjetesh financiare për këtë automjet.

**27. Automjet<sup>61</sup>**, në pronësi të bashkëshortit, fituar me kontratën e shiblerjes nr. \*\*\* kol., datë 31.1.2009, i llojit “autoveturë”, marka “\*\*\*\*”, tipi “\*\*\*\*”. Vlera 980, 000 lekë. Pjesa takuese 50%.

**Burimi sipas deklaratës “Vetting”:** kredia e marrë në vitin 2008 dhe e cituar më sipër. Sqaron se kredia është marrë në shumën 50,000 euro. Me këtë shumë është blerë apartamenti në Fier në vitin 2008 në vlerën 4,200,000 lekë dhe pjesa e mbetur prej 2,800,000 lekë është përdorur për blerjen e këtij automjeti dhe mobilimin e apartamentit.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- *Deklarim i rremë dhe mungesë burimi financiar i ligjshëm për automjetin me targa \*\*\*, blerë në vlerën 980.000 lekë, pasi është deklaruar se burim për blerjen e tij është kredia e marrë në vitin 2008 në “BKT” në shumën 50,000 euro, ndërkohë që rezulton se vlera totale e kredisë ka kaluar e gjitha për blerjen e apartamentit.*
- *Deklarim i rremë dhe mungesë burimi financiar i ligjshëm për shpenzimet e deklaruara për mobilimin e apartamentit, në shumën rreth 1, 800, 000 lekë, pasi është deklaruar se burim për këto shpenzime janë përdorur nga kredia e marrë në vitin 2008 në “BKT” në shumën 50,000 euro ndërkohë që rezulton se vlera totale e kredisë ka kaluar e gjitha për blerjen e apartamentit. Gjithashtu në deklaratën e interesave privatë periodikë vjetorë 2008, nuk është deklaruar nga subjekti që qëllimi i kredisë të jetë dhe për mobilim apartamenti.*

### **Hetimi<sup>62</sup>/ analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**27.1.** Me kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 31.1.2009, bashkëshorti i subjektit ka blerë automjetin tip “\*\*\*\*”, në shumën 980,000 lekë. Në deklaratën “Vetting”, por dhe në DVP/2008, si burim për blerjen e këtij automjeti është deklaruar kredia e marrë në bankën “BKT”.

<sup>61</sup> Subjekti ka dorëzuar këto dokumente: kontratë shitblerjeje automjeti nr. \*\*\* rep., dhe nr. \*\*\* kol., datë 31.1.2009.

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.09.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor.

**27.2.** Si burim për blerjen e makinës ka shërbyer shuma 1 milion lekë e mbetur nga kredia 50,000 euro, marrë në vitin 2008, sikurse është deklaruar nga subjekti në DPV/2008 dhe në deklaratën “Vetting”. Kjo shumë ka mbetur *cash* pas kthimit të shumës 1,8 milion lekë nga shitësi i apartamentit në Fier, z. Sh. S., në datën 18.6.2008. (trajtuar në pikën 24.3)

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka patur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e automjetit.

**27.3.** Pas analizimit të dokumentacionit dhe kryerjes së analizës financiare trupi gjykues vlerëson se nuk rezultojnë paqartësi apo pamjaftueshmëri mjetesh financiare për këtë automjet.

**28.** Gjendje *cash* në shumën 700,000 lekë. Të ardhura të kursyera nga paga e subjektit dhe e bashkëshortit në vite. Pjesa takuese 50%.

Nga analiza financiare duket se subjekti ka patur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të patur gjendjen *cash* në shumën 700,000 lekë.

## **29. Në lidhje me të ardhurat e bashkëshortit**

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- *Mungesë dokumentacion justifikues ligjor për të ardhurat e deklaruara nga punësimi i bashkëshortit pranë shoqërisë “\*\*\*\*” në shumën 2.900.000 lekë, çka e bën deklarin e rremë.*
- *Të ardhurat e deklaruara nga aktiviteti privat i bashkëshortit në shumën 1,340,000 lekë, nuk konfirmohen nga institucionet përkatëse.*

## **Hetimi<sup>63</sup>/ Analiza ligjore-financiare kryer nga Komisioni**

Subjekti në deklaratën “Vetting” ka deklaruar:

**29.1.** Të ardhura të bashkëshortit si i punësuar me kohë të pjesshme pranë klinikës mjekësore “\*\*\*\*”, Fier, për periudhën 2010-2015. Shuma e të ardhurave të krijuara: **2,900,000 lekë.**

Këto të ardhura janë deklaruar si më poshtë në deklarinet periodike.

Viti	Shuma/lekë
2010	450,000
2011	540,000
2012	400,000
2013	540,000
2014	600,000
2015	230,000

Në total 2,760,000 lekë.

**29.1.1.** Në lidhje me këto të ardhura subjekti<sup>64</sup> ka depozituar shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.11.2020, të DRT-së Fier, në të cilën deklarohet se z. V. M. është deklaruar në skemën e sigurimeve shoqërore nga subjekti E. J.<sup>65</sup>, me NIPT \*\*\*. Sipas tabelës janë llogaritjet e listpagesës së sigurimeve shoqërore dhe pagesës së Tap-it për vitin 2010-2013. Paga e vitit 2010 është llogaritur në TAP-in e vitit 2011.

<sup>63</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019 drejtuar QKB-së.

<sup>64</sup> Shih përgjigjet e pyetësorit të datës 9.11.2020 kthyer nga subjekti në datën 16.11.2020. Këto të ardhura janë konfirmuar dhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2020, të DRT-së Fier.

<sup>65</sup> \*\*\* është emri tregtar.

Periudha	Paga Bruto/lekë	Totali i sigurimeve/lekë	Tap për pagesë/lekë	Të ardhura netot/lekë
1112	1,127,187	24,468	112,719	990,000
1212	472,802	25,522	47,280	400,000
1312	629,490	26,541	62,949	540,450

Për periudhën 2014-2015 është llogaritur dhe paguar tatim në burim në shumën 124,500 lekë sipas vlerës së paguar zotit V. M. 830,000 lekë.

**29.1.2.** Bazuar në shkresën e mësipërme rezulton se për të ardhurat e bashkëshortit nga punësimi pranë “\*\*\*” janë paguar detyrimet tatimore, për rrjedhojë, këto të ardhura do të përfshihen në analizë financiare. Duke qenë se nga shkresa e DRT-së Fier rezulton se për vitet 2010 dhe 2011 detyrimet janë paguar në vitin 2012, shumat e përfituara nga të ardhurat për këto vite, janë përfshirë në analizë sipas deklarimeve që ka bërë subjekti në deklaratat periodike. Shuma totale e llogaritur për efekt të pagimit të detyrimeve tatimore është e njëjtë me shumën totale të deklaruar nga subjekti në DVP/2011 - 2012 prej 990,000 lekë. E njëjta llogaritje është bërë dhe për periudhën 2013 - 2014, por duke zbritur tatimin në burim. Në vitin 2014 është përfshirë shuma 600,000 lekë, ndërsa në 2014 është përfshirë shuma 105,500 lekë.

**29.2.** Të ardhurat e realizuara për periudhën 2008 - 2010 nga klinika mjekësore private, regjistruar nga bashkëshorti si subjekt i biznesit të vogël me NIPT \*\*\*. Shuma e të ardhurave të krijuara: 1,340,000 lekë.

Këto të ardhura janë deklaruar si më poshtë në deklaratimet periodike:

Viti	Paga lekë	Qira lekë	Shpenzime për hapjen	Fitimi lekë
2008	30,000	30,000	200,000	240,000
2009		120,000		950,000
2010				150,000
<b>Totali</b>	<b>30,000</b>	<b>150,000</b>	<b>200,000</b>	<b>1,340,000</b>

**29.2.1.** Në lidhje me këto të ardhura, në përgjigje të pyetësorit nr.1, subjekti ka vënë në dispozicion:

**(i) Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2018 të DRT-së Fier**

Sipas kësaj shkrese rezulton se z. V. M. ka qenë i regjistruar si tatimpagues, person fizik me NIPT \*\*\*, me aktivitet "Aktivitete të praktikës mjekësore, ambulatore", me datë regjistrimi 16.10.2008, me datë çregjistrimi 23.8.2010. Përgjegjësia tatimore e tatimpaguesit gjatë kohës së kryerjes së aktivitetit ka qenë: tatim fitim i thjeshtuar, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatim mbi të ardhurat nga punësimi. Për vitet 2008 - 2010 qarkullimi dhe fitimi i realizuar për tatimpaguesit biznes i vogël deklaroheshin në deklaratën vjetore të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël. Këtë deklaratë, bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, neni 12, e plotësonin subjektet me xhiro 2 deri në 8 milion lekë. Duke qenë se për vitet 2008 - 2010 bashkëshorti i subjektit nuk e ka patur përgjegjësinë tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël, DRT-ja Fier nuk mund të konfirmojë qarkullimin dhe fitimin e realizuar.

Ndërkohë DRT-ja Fier konfirmon pagimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën tetor 2008 – qershor 2010.

(i) Vërtetim, datë 1.2.2016, i Bashkisë Fier, ku deklarohet se z. M. ka qenë i regjistruar si subjekt i biznesit të vogël, me NIPT \*\*\*, për vitet 2008-2010, me xhiro të deklaruar deri në 2, 000, 000 lekë, si dhe ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë.

**29.2.2.** Nga hetimi ka rezultuar se:

**a.** QKB-ja informon se z. V. M. figuron i regjistruar si person fizik, me NIPT \*\*\*, por aktualisht me status “i çregjistruar”. Bazuar në ekstraktin historik z. M. është regjistruar në datën 16.10.2008, me fushë veprimtarie “Klinikë mjekësore” në adresën: lagjja “\*\*\*”, Fier. Në datën 23.8.2010 është çregjistruar.

**b.** DRT Fier informon se :

Z. V. M. rezulton të ketë qenë i regjistruar si person fizik me datë regjistrimi 16.10.2008 dhe datë çregjistrimi 23.08.2010. Tatimpaguesi rezulton të ketë qenë i regjistruar person fizik me përgjegjësinë tatimfitim i thjeshtuar. Përgjegjësitë tatimore të tatimpaguesit kanë qenë:

- Tatimfitim i thjeshtuar
- kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore,
- tatim mbi të ardhurat nga punësimi

Për vitet 2008 - 2010 tatimpaguesi nuk ka pasur përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël dhe nuk mund të konfirmohet qarkullimi dhe fitimi i realizuar. Për vitet 2008 - 2010 tatimi mbi biznesin e vogël është administruar nga pushteti vendor.

**c.** Subjekti ka vënë në dispozicion vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2016, nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Bashkia Fier, për bashkëshortin e saj, sipas të cilit ai ka qenë i regjistruar si biznes i vogël, me NIPT \*\*\*, për vitet 2008 - 2010 dhe ka deklaruar xhiro deri në 2,000,000 lekë/vit kalendarik, si dhe ka shlyer detyrimet ndaj Bashkisë.

Në përfundim rezulton se:

- i. bashkëshorti i subjektit ka qenë i regjistruar në organet tatimore për periudhën 2008-2010;
- ii. bashkëshorti i subjektit ka paguar kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për periudhën tetor/2008 - qershor 2010;
- iii. DRT-ja Fier nuk konfirmon qarkullim dhe fitim, për shkak se tatimpaguesi nuk ka pasur përgjegjësi tatimore të tatimit mbi të ardhurat personale të biznesit të vogël;
- iv. Drejtoria e Taksave, Bashkia Fier, deklaroi se ai ka qenë i regjistruar si biznes i vogël, me NIPT \*\*\* për vitet 2008-2010 dhe ka deklaruar xhiro deri në 2,000,000 lekë/vit kalendarik.

Në analizën financiare është përfshirë fitimi nga klinika private, duke qenë se z. M. ka qenë i regjistruar në QKB dhe organet tatimore, ka paguar sigurimet shoqërore dhe detyrimet tatimore, si dhe të ardhurat janë deklaruar periodikisht në DVP-të përkatëse. Fitimi është përfshirë sipas deklarimeve të subjektit në deklaratat periodike për sa kohë që nga llogaritja e kryer, duke zbritur detyrimet tatimore dhe shpenzimet për këtë aktivitet me një xhiro 2,000,000 lekë, fitimi është më i lartë se ai i deklaruar nga subjekti.

**29.3.** Nga hetimi, bazuar në shkresën e ISSH-së, rezulton se ishin paguar kontributet e sigurimeve për bashkëshortin e subjektit për muajt shkurt, mars 2015, nga shoqëria “\*\*\*”. Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, sqaroi se *në muajin shkurt 2015 bashkëshorti i saj ishte kontraktuar si mjek i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k, por në muajin prill, duke qenë së ka ardhur të jetojë në Tiranë e ka shkëputur këtë marrëdhënie pune, ndaj dhe pagesat janë vetëm për muajt shkurt - mars.*

Subjekti ka vënë në dispozicion:

- (i) kontratë me kohë të pjesshme, datë 22.1.2015, lidhur midis “\*\*\*” sh.p.k. dhe bashkëshortit të saj;

(ii) kontratë me kohë të pjesshme, datë 3.2.2015, lidhur midis “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe bashkëshortit të saj.

Këto të ardhura janë përfshirë në analizën financiare.

**29.4.** Nga verifikimi në regjistrin *online* të QKB-së ka rezultuar se bashkëshorti i subjektit është regjistruar si person fizik në datën 13.11.2019, me NIPT \*\*\*, si mjek pneumolog në adresën: rruga “\*\*\*\*”, pallati “\*\*\*\*”, shk. \*\*\*, ap.\*\*\*, Tiranë.

Në lidhje me këtë konstatim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, ka deklaruar se: *“Bashkëshorti im V. M. nuk ka hapur klinikë, por ka hapur një licencë si profesionist i lirë, në mënyrë që të mundej, në përputhje me ligjin, të ofronte shërbimin të tij si pneumolog në spitale apo klinika të ndryshme mjekësore. Adresa e deklaruar është adresa e apartamentit tonë të banimit dhe është pasqyruar aty për të vetmen arsye se aplikimi kërkonte një adresë. Për shkak të pandemisë nga Covid - 19 dhe problemeve shëndetësore, bashkëshorti nuk ka mundur të ushtrojë fare aktivitetet. Bashkëlidhur do të gjeni të gjithë praktikën e regjistrimit të bashkëshortit si person fizik.”*

**29.5.** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se në analizën financiare të subjektit do të përfshihen si të ardhura të bashkëshortit, me burim të ligjshëm, përkatësisht:

(i) për periudhën 2008 – 2010, shuma 1, 340, 000 lekë, e përfituar nga klinika mjekësore e bashkëshortit.

(ii) për periudhën 2010 – 2015, shuma 2,760,000 lekë, e përfituar nga punësimi pranë klinikës “\*\*\*\*”.

## **DETYRIME FINANCIARE**

**30. Huadhënie<sup>66</sup>,** në shumën 18,500 euro, sipas kontratës së huadhënies nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.9.2015, me afat 10-vjeçar. Shuma e detyrimit financiar që ka mbetur e pashlyer është 17,500 euro.

### **Konstatimi i ILDKPKI-së:**

- *Mungon burimi financiar i ligjshëm i shtetasit B. S. , për huan e dhënë në shumën 18,500 euro, çka e bën deklarin e rremë.*

## **Hetimi<sup>67</sup>/ analiza ligjore - financiare kryer nga Komisioni**

**30.1.** Me kontratën e huadhënies nr. \*\*\*, datë 24.9.2015, bashkëshorti i subjektit ka marrë hua shumën 18, 500 euro nga shtetasi B. S. . Qëllimi i dhënies së huas është për shlyerjen paraprake të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga huamarrësit në vitin 2008. Huadhënësi deklaron se shumën e dhënë hua e disponon në sajë të të ardhurave dhe kursimeve familjare. Në kontratë përcaktohet se huadhënësi deklaron se i ka dorëzuar huamarrësit shumën e huas prej 18,500 euro, shumë e cila është dhënë dorazi. Afati i dhënies së huas është 10 vjet.

**30.2** Në lidhje me këtë hua subjekti në seksionin “Të dhëna konfidenciale” të deklaratës “Vetting” deklaron: *“Huadhënës është B. S. S., që është bashkëshorti i motrës së saj M. S. dhe huamarrës është bashkëshorti V. M.. Kjo hua është marrë për të shlyer pjesën e mbetur të kredisë së marrë në vitin 2008 për apartamentin ne Fier, në sajë të kontratës nr. \*\*\* rep.,*

<sup>66</sup> Subjekti ka dorëzuar kontratë huadhënieje nr. \*\*\* rep., nr.\*\*\* kol., datë 24.9.2015.

<sup>67</sup> Shkresë, nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020 drejtuar Bankave; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar Arkivit Qëndror të ISSH-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar QKB-së; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë.

nr. \*\*\* kol., datë 12.3.2008. Me shumën e marrë hua, është kryer shlyerja tërësore e kredisë më datë 5.10.2015. Deri tani, shtetasit B. S. i është paguar një shumë prej 1, 000 eurosh.”

**30.3.** Në lidhje me burimin e të ardhurave të z. S., subjekti sqaron se: “...Sikundër e kam shprehur më sipër, këtë shumë B. S. e ka siguruar nga kredia bankare e marrë në shumën 2,800,000 (dy milion e tetëqind mijë) lekë, të cilën, sapo e ka marrë, na ka dhënë në shumën prej 18,500 (tetëmbëdhjetë mijë e pesëqind) euro.” Subjekti ka depozituar deklaratë noteriale të z. B. S. , nr. \*\*\*, datë 11.5.2020”, ku ai deklaron se: “...Shlyerja e kësaj kredie ka qenë dhe në interesin tim, pasi kolateral për shlyerjen e saj ishte vendosur një pronë e ndodhur në \*\*\*, Vlorë, në pronësi të babait tim S. S....mua nuk më jepej vlera e shpronësimit, por mbahej e bllokuar nga Banka një shumë prej 5,520,000 lekë, pasi prona ishte e vënë si garanci lidhur me kredinë që kishte marrë shtetasi V. M.. Shlyerja e kredisë çliroi pronën time nga barra dhe unë përfitova shumën e sipërcituar të shpronësimit. .... **Lidhur me burimin...deklaroj se ato janë të siguruar nga një kredi** që unë sapo kisha marrë në shumën 2,800,000 lekë në “Credins Bank” sipas kontratës nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2015...”

**30.3.1.** Subjekti ka depozituar:

- i. kontratë kredie, nr. \*\*\*, datë 25.9.2015 (nr. \*\*\*, datë 28.09.2015), nëpërmjet së cilës z. B. S.ka marrë hua shumën 2,800,000 lekë për blerje apartamenti;
- ii. derdhje në “Credins Bank” nga z. B. S.në shumën 18, 000 euro. më 2.10.2015, me emërtimin“... nga konvertimi i kredisë”.
- iii. tërheqje nga llogaria në “Credins Bank” e z. B. S.në shumën 17.900 euro, më 5.10.2020.

**30.3.2.** Bazuar në nxjerrjen e llogarisë së z. S. në lekë në “Credins Bank”<sup>68</sup> rezulton se:

- i. në datën 30.9.2015 është disbursuar kredia në shumën 2,772,000 lekë;
- ii. në datën 30.9.2015, shuma 2,700,000 lekë i është transferuar z. I. J. me përshkrimin “sa kaluar për shlyerje detyrimi”.

**30.3.3.** Bazuar në nxjerrjen e llogarisë në euro në “Credins Bank” të z. S., rezulton se ai në datën 2.10.2015 ka depozituar shumën 18, 000 euro me përshkrim konvertim i kredisë. Kjo shumë është tërhequr në datën 5.10.2015.

**30.3.4** Në përfundim, ka rezultuar se:

- i. kredia është marrë në datën 28.09.2015, pra, pas dhënies së huas;
- (ii) qëllimi i kredisë ka qenë për blerje apartamenti;
- (iii) nga hetimi<sup>69</sup> ka rezultuar se z. S. ka lidhur kontratë sipërmartjeje në datën 20.11.2013<sup>70</sup> me shoqërinë “\*\*\*” për blerjen e një apartamenti në shumën 24, 000 euro. Pagesat për këtë apartament referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2020, të bankës “BKT”, janë bërë si më poshtë:
  - 10, 000 euro në datën 14.07.2016;
  - 7,000 euro në datë 13.9.2016;
  - 10,000 euro në datë 6.12.2016;
  - 7,000 euro në datë 26. 1.2017;
  - 5,000 euro në datë 27.2.2017;
  - 5.800 euro në datë 23.3.2017;**Totali 44.800 euro.**
- (iv) në datën 2.10.2015 z. S. ka depozituar shumën 18,000 euro në “Credins Bank” me burim nga konvertimi i kredisë;

<sup>68</sup> Shih shkresën kthim përgjigjeje të “Credins Bank” nr. \*\*\* prot., datë 30.6.2020.

<sup>69</sup> Shih shkresën e ASHK-së Vlorë, nr. \*\*\* prot., datë 20.5.2020.

<sup>70</sup> Në datën 17.5.2017 është lidhur kontrata e shitblerjes nr.\*\*\*.

- (v) në datën 5.10.2015 z. S. ka tërhequr shumën 17, 900 euro;
- (vi) në kontratën e huadhënies burim janë caktuar të ardhurat dhe kursimet familjare.

**30.3.5.** Pas kësaj analize Komisioni ka arritur në përfundimin se kredia e marrë nga huadhënësi nuk mund të shërbejë si burim, pasi ajo është marrë pas dhënies së huas. Për këtë konkluzion subjektit iu kërkuan shpjegime.

**30.3.6.** Në parashtrimet e paraqitura subjekti ka pretenduar se nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti më parë. Për këtë arsye, ajo i ka rikërkuar shpjegime kunatit të saj, zotit B. S., i cili ka rikonfirmuar të njëjtin burim për këtë huadhënie, duke qartësuar se në vitin 2013 ka marrë një hua prej 19,000 eurosh nga shtetasi I. J. dhe me kontratën për njohje detyrimi, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2015, ka marrë përsipër t'ia shlyejë këtë hua deri më 30.10.2015. Në këtë kontratë përcaktohet shprehimisht fakti që kjo hua do të shlyhet nëpërmjet kredisë bankare që do të merrej në “Credins Bank”, kredi për të cilën z. S. kishte aplikuar tashmë dhe më 30.9.2015 i është disbursuar shuma prej 2.772.000 lekësh në llogarinë e tij bankare. Po atë datë B. S. ia ka transferuar në llogari bankare shtetasit I. J., me përshkrimin “shlyerje detyrimi”, fakt ky i konstatuar edhe nga Komisioni.

Në shtator 2015 z. S. ka kërkuar të mundësohej lirimi i kolateralit të vendosur për kredinë e marrë nga subjekti, në mënyrë që të merrte pagesat e shpronësimit. Për të realizuar shlyerjen e plotë të kredisë, me qëllim lirim të kolateralit nga barra hipotekore, z. S. ka ofruar mundësinë e huadhënies tek subjekti dhe bashkëshorti i saj.

Subjekti ka pretenduar se: *“...kanë përfituar nga një vizitë e tyre familjare në Fier, për të shmangur lëvizjen enkas në Tiranë apo në Vlorë<sup>71</sup>, bashkëshorti im dhe kunati B., shkojnë që atë ditë, pra më datë 24.09.2015, tek një notere në Fier dhe e lidhën aty kontratën e huasë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., dt. 24.09.2015, me objekt dhënien hua të shumës 18.500 euro për një afat 10-vjeçar. Për bashkëshortin tim dhe kunatin nuk kishte ndonjë rëndësi fakti nëse shuma e huasë do të jepej në atë moment apo pas dy ditësh. Ata ishin në marrëdhënie besimi me njëri - tjetrin, aq më tepër që vetë B. ishte i interesuar për të na e dhënë huanë. Ndaj kur janë pyetur nga noteri lidhur me kohën dhe mënyrën e dhënies së shumës e kanë lënë të pandryshuar fjalinë sikundër ajo e ka patur në formatin që kishte të gatshëm. Pasi i ka kaluar shumën e kredisë shtetasit I. J., B. është takuar me të dhe i ka treguar për situatën e shpronësimit të pronës së tij dhe faktin që ishte detyruar të paguante kredinë që unë dhe bashkëshorti kishim marrë, që të mund të merrte paratë e shpronësimit. I. i është vetëofruar t'ia kthejë shumën që B. i kishte kaluar në sajë të kredisë së marrë, duke qenë se momentalisht nuk kishte probleme ekonomike dhe nuk i nevojiteshin. Duke e ditur se B. do të merrte 55 milionë lekë nga shpronësimi, ai ka rënë dakord që t'ia kthente shumën 18.000 euro dhe B. t'ia jepte sapo të merrte lekët e shpronësimit. Më datë 01.10.2015, shtetasi I.J. rezultoi të ketë tërhequr shumën prej 2.700.000 lekë me përshkrimin për konvertim, fakt ky i konfirmuar edhe me dokument bankar. Kjo shumë lekësh pasi konvertohet në euro i jepet z. B. S. , i cili më datë 02.10.2015, shumën prej 18.000 euro, e ka derdhur në llogarinë e tij në bankën Credins, me përshkrimin “nga konvertimi i kredisë”. Kjo pasi 18.000 eurot e depozituara, ishin pikërisht konvertimi i shumës prej 2.700.000 lekë, që B. kishte marrë nga kredia bankare. Me qëllim që të evitonte pagimin e komisionit bankar, i cili për shkak të shumës, do të ishte relativisht i lartë, B. e ka tërhequr shumën prej 18.000 euro pas 3 ditësh dhe ia ka dhënë bashkëshortit tim më datë 05.10.2015, i cili brenda ditës, pra po në datë 05.10.2015 i ka derdhur në BKT dhe ka bërë shlyerjen tërësore të kredisë. Në konkluzion të shpjegimeve të dhëna më sipër, B. ka deklaruar si burim të shumës që na është dhënë hua, kredinë e marrë nga ana e tij më 30.09.2015, sepse pavarësisht se kjo kredi është marrë për të shlyer huanë e shtetasit I. J., ka rezultuar që ky i fundit e ka kthyer atë mbrapsht dhe B. atë shumë ia ka dhënë hua bashkëshortit tim.”*

<sup>71</sup> Kunati jeton në Vlorë, kurse ne në Tiranë, sqaron subjekti.



Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme subjekti ka paraqitur si prova të reja: (i) kontratë për njohje detyrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2015, mes I. J. dhe B. S. ; (ii) llogarinë bankare të printuar të shtetasit I. J.; (iii) deklaratat noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2021, të shtetasit I. J.; (iv) deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2021, të shtetasit B. S..

**30.3.7.** Komisioni, pasi shqyrtoi shpjegimet dhe provat e reja të paraqitura nga subjekti, vlerëson se, pavarësisht se ato mund të konsiderohen bindëse për shkak të marrëdhënieve njerëzore e shoqërore, nuk janë të provuara me dokumentacion. Për pasojë, çmohet që këto shpjegime të subjektit të mos merren në konsideratë, por, gjithsesi, vlerësohet që pasaktësia e konstatuar në deklarinimin e z. S. nuk mund të penalizojë subjektin, për sa kohë ky deklarinim është noterial dhe përgjegjësia bie mbi deklaruesin.

**30.4.** Komisioni ka hetuar në lidhje me aftësitë huadhënëse të z. S., përtej marrëdhënies së huamarrjes me z. J.. Nga hetimi ka rezultuar se:

**30.4.1.** Z. B. S. figuron i regjistruar në QKB si person fizik me NIPT \*\*\*

Bazuar në ekstraktin historik z. S. është regjistruar në datën 17.10.2008 me fushë veprimtarie “Bar - kafe”. Aktualisht figuron i çregjistruar.

**30.4.2.** DRT-ja Vlorë informon se z. B. S. figuron i regjistruar si person fizik në datën 17.10.2008 dhe me fitim si vijon:

- viti 2008, fitimi 0 lekë;
- viti 2009, fitimi 431,827 lekë;
- viti 2010, fitimi 232,958 lekë;
- viti 2011, fitimi 493,551 lekë;
- viti 2012, fitimi 487,739 lekë;
- viti 2013, fitimi 479,997 lekë;
- viti 2014, fitimi 0 lekë;
- viti 2015, fitimi 134,160 lekë.

Në datën 27.6.2008 është me status “çregjistruar”.

**30.4.3.** Nga ana e ISSH-së konfirmohen pagesat si i punësuar pranë IEVP Paraburgimi, si dhe nga aktiviteti privat si person fizik gjatë periudhës janar 2012 - dhjetor 2016.

**30.4.4.** Bazuar në shkresën e DPSHTRR-së rezulton se z. S. ka blerë:

- automjet “\*\*\*\*”, në datën 12.08.2017, në shumën 1.000 euro dhe detyrime doganore në shumën 70,293 lekë;

- automjet “\*\*\*\*” me kontratën nr. \*\*, datë 11.11.2006, në shumën 250,000 lekë.

#### **30.4.5. Analizë financiare**

Huadhënësi	2011 deri më 24.9.2015
<b>Të Ardhura</b>	<b>7 193 073</b>
Fitimi nga biznesi	1 561 907
I.E.D.P. Paraburgimi Paga	2 237 551
Paga “****”, M. S.	2 261 999
Nga WU	8 259
<b>Shpenzime</b>	<b>6 244 167</b>
Shpenzimet e jetesës	3 221 588
Ndryshim likuiditetesh	-51 525
Paguar kredia tek “Union Bank”	22 029
Dhënë hua tek subjekti	2 546 525
Paguar kredia tek banka “Credins”	505 551

Analiza financiare është bazuar në metodologjinë kumulative, pasi huadhënësi nuk është subjekt deklarimi.

#### Në analizën financiare janë përfshirë/konsideruar:

- i. të ardhurat e huadhënësit nga viti 2011<sup>72</sup> dhe për bashkëshorten nga viti 2012, për sa ka dokumentacion provues mbi pagat e saj;
- ii. shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur sipas përbërjes familjare<sup>73</sup> për tre dhe katër persona respektivisht;
- iii. janë përfshirë në analizë likuiditetet në sistemin bankar dhe pagesat e kredive, të dala gjatë hetimit;
- iv. nuk është përfshirë si e ardhur kredia e marrë tek “Credins”, pasi kjo kredi nuk ka shërbyer si burim për shtimin e të ardhurave familjare ose për dhënien e huas<sup>74</sup>.

**30.4.6.** Nga analiza financiare ka rezultuar se z. B. S. nuk ka patur të ardhura të mjaftueshme në shumën 174,451 lekë për të dhënë hua shumën 18,500 euro. Subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me këtë rezultat të hetimit.

**30.4.7.** Në parashtrimet e paraqitura subjekti ka pretenduar se z. S. ka patur të ardhura të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje. **Rrethanat e reja** dhe provat<sup>75</sup> që ndikojnë në këtë përlllogaritje dhe që nuk dihen nga Komisioni janë:

- i. kalimi faktik i shumës së huas nga shtetasi B. S. tek bashkëshorti i subjektit V. M. është bërë më 5.10.2015 dhe jo më 30.9.2015, që është data e lidhjes së kontratës;
- ii. në vitin 2013 B. ka marrë hua nga shtetasi I. J. shumën 19.000 euro, fakt ky i dokumentuar edhe me kontratën për njohje detyrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2015, mes I. J. dhe B. S. ;
- iii. vërtetimet e pagave të dorëzuara paraprakisht për bashkëshortët S. nuk përfshijnë shuma të caktuara parash që u referohen shpërblimeve të marra dhe pagesave të gatishmërisë, të cilat e ndryshojnë diferencën e konstatuar nga Komisioni, duke sjellë një bilanc pozitiv në pasuritë e bashkëshortëve S..

**30.4.8.** Nga analiza e deklarimeve dhe dokumenteve të reja të vëna në dispozicion nga subjekti, Komisioni çmon se:

- i. të ardhurat e B. S. janë rishikuar sipas vërtetimit nga IEVP-ja;
- ii. të ardhurat e M. S. janë rishikuar pas krahasimit të pagës mujore bazuar në vërtetimet e ISSH-së me lëvizjet e llogarive bankare të sjella nga subjekti rishtazi;
- iii. shuma prej 28,690 lekësh, e pretenduar si e ardhur që ka rezultuar nga mospagimi i faturave nga ana e z. B. S. gjatë vitit 2015, nuk do të përfshihet në analizën financiare, pasi kjo mbetet në nivel deklarativ dhe nuk është vërtetuar me dokumentacion nga ana e subjektit;

<sup>72</sup> Para kësaj periudhe huadhënësi rezulton me balanca negative, element i cili, për një shtetas që nuk është subjekt deklarimi dhe analizohet me metodologjinë kumulative, do ta bënte të pakuptimtë dhe fiktive analizën financiare.

<sup>73</sup> Zotërinjtë S. kanë 2 fëmijë, të cilët kanë lindur më 3.9.2008 dhe 15.1.2011.

<sup>74</sup> Nga lëvizja e llogarisë së kredisë të z. B. S. në “Credins Bank”, rezulton se në datën 30.9.2008, menjëherë pas disbursimit shuma e kredisë është transferuar tek shtetasi I. J. me përshkrimin “sa kaluar per shlyerje detyrimi”.

<sup>75</sup> Subjekti ka depozituar: (i) analizë financiare e të ardhurave të shtetasit B. S., kryer nga z. E. M., kontabilist i miratuar me licencë me nr. \*\*\*, datë 4.9.2013; (ii) kontratë për njohje detyrimi nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2015 mes I. J. dhe B. S.; (iii) deklarata noteriale nr. \*\*\* rep nr. \*\*\* kol. datë 29.01.2021 e shtetasit I. J.; (iv) deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 29.1.2021 e shtetasit B. S.; (v) printim i llogarisë bankare të shtetasit I. J..

- iv. shuma e huas 19.000 euro në vitin 2013 nuk do të përfshihet si e ardhur, pasi subjekti ka sjellë prova vetëm për faktin e marrjes së kësaj huaje, por jo destinacionin e saj. Kështu, gjykohet që huaja të jetë marrë për t'u përdorur ose shpenzuar nga z. B. S.

Në përfundim të këtij vlerësimi, analiza financiare e z. S. paraqitet si më poshtë:

<b>Huadhënësi</b>	<b>Total</b>
<b>Të ardhura total</b>	<b>6 277 979</b>
Fitimi nga biznesi	1 561 907
IEVP Paraburgimi, Paga	2 330 271
Paga “****”, M. S.	2 377 542
Marrë nga WU	8 259
<b>Shpenzime total</b>	<b>6 244 167</b>
Shpenzimet e jetesës	3 221 588
Ndryshim likuiditetesh	-51 525
Paguar kredi te “Union Bank”	22 029
Paguar kredi te “Credins”	505 551
Dhënë hua tek subjekti	2 546 525
<b>Mundësia për kursim</b>	<b>33 812</b>

**30.4.9.** Pas shqyrtimit të provave dhe rrethanave të reja, të paraqitura nga subjekti, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e huadhënësit duhet të konsiderohen të mjaftueshme për dhënien e kësaj huaje.

**30.5.** Nga nxjerrja e llogarisë së bashkëshortit të subjektit në BKT rezulton se z. B. S. dhe znj. M. S. kanë depozituar shumat e mëposhtme në llogarinë e tij:

- në datën 2.7.2012, 550 euro;
- në datën 7.1.2013, 550 euro;
- në datën 7.12.2012, 490 euro;
- në datën 9.4.2013, 600 euro;
- në datën 19.2.2015, 910 euro;
- në datën 21.4.2015, 600 euro;

**30.5.1.** Në lidhje me këto pagesa subjekti sqaron se ato janë nga të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit për shlyerjen e kredisë, por që fizikisht janë depozituar nga bashkëshortët S., për shkak të pamundësisë të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

**30.5.2.** Këto pagesa janë përfshirë në analizën financiare të subjektit si shlyerje e kredisë dhe mundësia financiare e subjektit për këtë shlyerje pasqyrohet në tabelën përmbledhëse përfundimtare, vitet 2008 – 2015.

**30.6.** Në përfundim të analizës për huan e dhënë nga B. S., me qëllim shlyerjen e plotë të kredisë së marrë nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, Komisioni çmon se shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti janë bindëse. Paqartësia/pasaktësia në shpjegimet e huadhënësit, nuk mund të penalizojë subjektin, për aq kohë sa ka qenë tërësisht bashkëpunues, duke shpjeguar dhe provuar aftësitë huadhënëse të z. S..

## **DEKLARIMI I BASHKËSHORTIT SË SUBJEKTIT – V. M.**

**31. Apartament<sup>76</sup>, 3+1** në lagjen “\*\*\*\*”, Kuçovë, blerë nga Enti Kombëtar i Banesave, Berat. Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.3.2007, babai im M. M., nëna N. dhe

<sup>76</sup>Subjekti ka dorëzuar: kontratë shitjeje apartamenti me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 26.3.2007.

dy vëllezërit M. dhe E. M., jemi bashkëpronarë në pjesë të barabarta. Vlera 548.248 lekë. Pjesa takuese 1/5. Bashkëlidhur kopje të kontratës.

## Hetimi<sup>77</sup>/ analiza ligjore - financiare kryer nga Komisioni

**31.1.** Me kontratë shitjeje apartamenti me pagesë të menjëhershme nr. \*\*\*, datë 26.3.2007, familjarët e bashkëshortit të subjektit kanë blerë nga Enti Kombëtar i Banesave apartament me sipërfaqe 137 m<sup>2</sup>, nr. pasurie \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, në Kuçovë, në shumën 548,248 lekë. Kjo pasuri është deklaruar në DVP/2007.

**31.2.** Nuk rezultojnë paqartësi për këtë pasuri.

## 32. Në lidhje me shkollimin e djalit të subjektit

**32.1.** Në datën 9.7.2019 djali i subjektit të rivlerësimit ka një kreditim në shumën 6,000 euro në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank”. Në lidhje me këtë kreditim, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr.1, sqaron se shuma prej 6,000 euro në llogarinë e djalit të saj K. M. më 9.7.2019 është bërë pasi kërkohej si garanci për të marrë lejen e qëndrimit si student në universitetin “\*\*\*” në Vjenë. Kjo shumë, ashtu sikundër është deklaruar në bankë, është siguruar nga kursimet e të ardhurave të saj dhe të bashkëshortit, deklaruar edhe në deklaratat përkatëse të pasurisë. Më konkretisht, në deklaratën vjetore të pasurisë për vitin 2016, janë deklaruar të ardhura *cash* nga kursimet 700,000 lekë, të cilat në vitin 2017 janë shtuar me 200,000 lekë dhe kanë shkuar 900,000 lekë. Në vitin 2018 nuk ka ndryshim të pasurisë dhe të ardhurat *cash* kanë ruajtur vlerën 900,000 lekë, të cilat kanë qenë edhe burimi i të ardhurave për pagesën e kryer.

Në analizën financiare të vitit 2019, shuma 730,255 lekë (5,995 euro), e derdhur në “Raiffeisen Bank”, është përfshirë në analizë si pjesë e likuiditeteve.

**32.2.** Nga lëvizjet e llogarisë së bashkëshortit të subjektit në bankën “BKT”, si dhe nga “Vërtetim pagese” nga “\*\*\*”, Austri, rezultojnë se janë kryer këto transfera:

- i. në datën 28.5.2019 bashkëshorti i subjektit ka paguar 6.166 euro<sup>78</sup> për tarifën e shkollimit (vjeshtë 2019);
- ii. në datën 26.12.2019 bashkëshorti i subjektit ka paguar 3.166 euro për tarifën e shkollimit (pranverë 2020).

**32.3.** Nga lëvizjet e llogarisë në “Raiffeisen Bank” rezultojnë se subjekti ka kryer disa transfera për të paguar shpenzime studimet e djalit të saj K. M.:

- i. në datën 10.7.2019 subjekti ka transferuar shumën 740 euro;
- ii. në datën 19.9.2019 subjekti ka transferuar shumën 7,027.90 euro;
- iii. në datën 3.10.2019 subjekti ka transferuar shumën 1,026 euro.

Në total, shuma 18,125.90 euro është paguar për shkollën dhe jetesën e djalit<sup>79</sup> gjatë vitit 2019.

	2019
<b>PASURI</b>	<b>-177 236</b>
Shtesa/pakësime, likuiditete	-177 236
Likuiditete gjendje	730 207

<sup>77</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2019, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020, drejtuar ASHK-së Kuçovë.

<sup>78</sup> Dy konfirmime pagese nga universiteti, të datës 7.5.2020, për secilën pagesë.

<sup>79</sup> Nga ballafaqimi i dërgesave të kryera nga subjekti nga “Raiffeisen Bank” në Shqipëri me lëvizjen e llogarisë së K. M. në “Raiffeisen Bank”, Austri, rezultojnë se shuma 8,000 euro është përdorur për qira dhe shpenzime të tjera.

<b>Të ardhura, dokumentuar</b>	<b>3 619 585</b>
Të ardhura nga paga e subjektit	2 450 939
Të ardhura nga paga e bashkëshortit	1 168 646
<b>SHPENZIME</b>	<b>3 584 010</b>
Shpenzime jetese	903 011
Shpenzime udhëtimi, TIMS	249 622
Shpenzime shkollimi për djalin K. M.	2 207 191
Shpenzime shkollimi për djalin K. M.	219 186
Shpenzime për hapjen e licencës së klinikës së bashkëshortit	5 000
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>212 812</b>

**32.4** Në përfundim ka rezultuar se subjekti ka patur mundësi financiare për të mbuluar shpenzimet e shkollimit të djalit të saj.

**33.** Në përfundim të hetimit Komisioni ka kryer analizën financiare për subjektin.

*Tabela përmbledhëse mbi mundësinë financiare të subjektit nga fillimi i detyrës*

<i>Përshkrimi</i>	<i>2004</i>	<i>2005</i>	<i>2006</i>	<i>2007</i>	<i>2008</i>	<i>2009</i>	<i>2010</i>
1. Pasuri	281	313 692	29 783	485 149	5 037 322	-84 373	-28 597
2. Detyrime	0	0	0	0	5 950 960	-497 856	-568 867
<i>3. Pasuri Neto (1-2)</i>	281	313 692	29 783	485 149	-913 637	413 482	540 270
4. Të ardhura	703 131	1 099 379	1 083 933	1 185 862	1 528 668	2 150 563	1 987 553
5. Shpenzime	281 892	353 671	478 671	520 860	2 002 495	1 159 361	1 106 851
6. Të ardhura neto	421 239	745 708	605 262	665 002	-473 827	991 202	880 702
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>420 958</b>	<b>432 016</b>	<b>575 479</b>	<b>179 853</b>	<b>439 810</b>	<b>577 720</b>	<b>340 432</b>

<i>Përshkrimi</i>	<i>2011</i>	<i>2012</i>	<i>2013</i>	<i>2014</i>	<i>2015</i>	<i>2016</i>	<i>TOTAL</i>
1. Pasuri	541 286	-802 969	434 056	674 504	-144 513	-404 782	6 050 837
2. Detyrime	-616 898	-664 480	-710 367	-791 167	-246 735	-135 270	1 719 319
<i>3. Pasuri Neto (1-2)</i>	1 158 185	-138 489	1 144 423	1 465 671	102 222	-269 512	4 331 518
4. Të ardhura	2 194 608	2 046 719	2 044 079	2 850 496	2 262 642	2 154 744	23 292 377
5. Shpenzime	1 223 125	1 091 358	1 371 279	1 337 584	1 389 569	1 935 289	14 252 005
6. Të ardhura Neto	971 483	955 361	672 800	1 512 912	873 073	219 455	9 040 371
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-186 702</b>	<b>1 093 850</b>	<b>-471 623</b>	<b>47 241</b>	<b>770 851</b>	<b>488 967</b>	<b>4 708 853</b>

**33.1.** Në përfundim ka rezultuar se subjekti ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për vitin 2011 në shumën 186, 702 lekë dhe për vitin 2013 në shumën 471, 623 lekë, në total periudhën 2004 -2016 në shumën - 658 325 lekë. Për këtë iu kalua barra e provës.

**33.2.** Në përgjigje të barrës së provës subjekti ka prapësuar se janë dy rrethanat që kanë sjellë këtë rezultat negativ:

i. së pari, keqkuptimi nga ana e saj e mënyrës së deklarimit të gjendjes *cash*. Qartësimi i kësaj është bërë në vitin 2013 dhe që nga ajo periudhë ka qenë e qartë dhe e saktë në deklarim. Në këtë kontekst, subjekti ka pretenduar se në fund të vitit 2010 ka patur një gjendje likuiditeti pozitive në vlerën 340.432 (treqind e dyzet mijë e katërqind e tridhjetë e dy) lekë, vlerë kjo që derisa nuk është shpenzuar, është kursyer dhe duhet të përlllogaritet si e ardhur për vitin 2011. Në vitin 2012 rezultoi që më 27.12.2012 ka tërhequr 400.000 lekë, të cilat janë gjendje *cash* në banesë, pasi nuk ka kryer asnjë pagesë për 4 ditët e mbetura të vitit 2012. Shuma 400.000 lekë duhet përlllogaritur tek të ardhurat e vitit 2013.

ii. së dyti, pagesa e kryer për pushimet në Antalia Turqi, për periudhën 14.8.2013-24.8.2013, të cilat janë përlllogaritur nga ana e Komisionit në shumën 2.200 euro dhe janë paraqitur si shpenzime të kryera në vitin 2013. Kostoja e këtyre pushimeve realisht është në shumën 1.800 euro dhe është parapaguar në nëntor të vitit 2012, me qëllim për të përfituar nga ofertat e rezervimit të parakohshëm, fakt ky që konfirmohet me vërtetimin e lëshuar nga kompania “\*\*\*”.

Për të provuar pretendimet e saj, subjekti ka depozituar edhe analizë financiare të kontabilistit të miratuar, z. E. M..

**33.3.** Komisioni vlerësoi provat dhe shpjegimet e subjektit. Nga shqyrtimi i *statement*-it bankar rezultoi se më 27.12.2012 është tërhequr shuma prej 400, 000 lekë, por subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë si gjendje *cash* në fund të vitit. Po kështu, edhe në DVP/2011 subjekti nuk ka deklaruar *cash* gjendje në fund të vitit 2010. Për pasojë, Komisioni vlerëson të mos e marrë në konsideratë këtë pretendim të subjektit. Deklarimi i gjendjes *cash* është detyrim ligjor. Në lidhje me pagesën për pushimet, subjekti ka vënë në dispozicion një vërtetim të “\*\*\*\*”, sipas së cilit, pagesa prej 1, 800 euro është bërë në muajin nëntor 2012. Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë këtë provë dhe të ribëjë analizën financiare për vitin 2013. Në përfundim të kësaj analize rezultoi se subjekti ka qenë në pamundësi mjetesh financiare për vitin 2013 në shumën -163 161 lekë, ndërsa në total, mangësia e mjeteve financiare rezultoi të jetë 349, 863 lekë.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**34.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën “Vetting”, pasuritë e tij dhe personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

**34.1.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ajo ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së saj. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**34.2.** Siç u pasqyrua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor në rezultatet financiare të viteve respektive.

**34.3.** Në lidhje me problematika e konstatuara/ çështjet e trajtuar me lartë në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se: (i) deklarimi i pasaktë i kuantitetit të subjektit në lidhje

me burimin e huas, nuk mund të penalizojë subjektin, për sa kohë subjekti ka deklaruar atë çfarë ka shprehur hudhënësi me deklaratë noteriale; (ii) balanca negative e fondeve në vitin 2011 prej 186, 702 lekë dhe në vitin 2013 në shumën -163, 161 lekë, nuk është e mjaftueshme që të passjellë zbatimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi vlerësimi sigurisht që duhet të kryhet nëpërmjet një analizë kritike, por ai duhet të jetë gjithëpërfshirës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

**34.5.** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara apo mungesa financiare si më sipër nuk duhet të ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe mungesës së pasojave, ato nuk cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

**34.6.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Miha, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**35.** Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka patur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**35.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>80</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramet është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës si dhe; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**35.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

**35.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**36.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Elsa Miha, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>80</sup> Raporti me nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017.

## C. VLERËSIMI PROFESIONAL

### Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë

**37.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**37.1.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (1) formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe; (3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**37.2.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale dhe; (ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

### **37.3. Gjetjet në lidhje me 5 dosjet penale të përzgjedhura me short**

Komisioni, nga 5 dosjet e analizuara, i kërkoi shpjegime subjektit vetëm për dosjen 1, si më poshtë:

**1. Kallëzimi penal nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, mosfilluar më 28.5.2015.**

Më 28.5.2015 është vendosur “Mosfillimi i procedimit penal për materialin kallëzues nr. \*\*\* të vitit 2015”, mbështetur në nenet 290/1/ç dhe 291 të K.Pr.Penale, pasi fakti nuk përbën elementet e veprave penale “Shpërdorim i detyrës” dhe “Shkelje e barazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike”, parashikuar përkatësisht nga nenet 248 dhe 258 të K.Penal dhe as të ndonjë veprë tjetër penale.

**Dokumenti ligjor “Vendim mosfillimi”,** është i strukturuar në tri pjesë: pjesa hyrëse, pjesa përshkuese dhe dispozitivi.

Nga përmbajtja e dokumentit, konstatohet se janë respektuar rregullat e drejtshkrimit, fjalitë paraqiten të qarta dhe përmbajnë referenca ligjore. Dokumenti paraqitet i strukturuar në mënyrë të rregullt, paragrafët janë të ndarë nga njëri-tjetri, teksti paraqitet i kuptueshëm. Vendimi paraqitet i arsyetuar nga pikëpamja ligjore në të gjithë elementët e tij. Fashikulli i kallëzimit penal paraqitet i plotë. Nga pikëpamja e formës, renditja e akteve procedurale pasqyron administrim të rregullt të dosjes.

Subjektit iu kërkuan shpjegime pasi rezultoi se vendimi i mosfillimit të procedimit penal nuk u është njoftuar subjekteve të interesuara.

Në parashtrimet e paraqitura, subjekti ka pretenduar se ka mundësi që shkresa e komunikimit të mos jetë fotokopjuar nga sekretaria, së bashku me dosjen. Bashkëlidhur subjekti ka depozituar shkresën nr. \*\*\* prot., datë 18.06.2015, me lëndë “Dërgohet për njoftim vendimi i prokurorit” dhe i drejtohet palës kallëzuese shoqëria “\*\*\*\*”sh.p.k. në adresën e deklaruar prej saj.

Për sa më sipër subjekti ka provuar që nga ana e saj është njoftuar subjekti i interesuar.



## 37.4. ANALIZA E GJETJEVE

Analiza e gjetjeve u referohet të dhënave të nxjerra nga tri grupet e burimeve të informacionit:

- i. formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti;
- ii. 5 dosjeve të vëzhguara, të përzgjedhura me short;
- iii. të dhënat nga burimet arkivore pranë Prokurorisë së Përgjithshme.

### 1. Aftësitë profesionale

#### a) *Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon drejt normën ligjore të zbatueshme dhe argumenton arsyet zbatimin e saj në rastin konkret.

Në lidhje me zbatimin e ligjit material, i kushton rëndësi analizës së elementëve të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin ligjor të faktit penal.

Subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi në interpretimin e ligjit, analizën e provave dhe arsyetimin ligjor e logjik, duke marrë e përpiluar vendime e akte të kuptueshme, me tekst të qartë.

#### b) *Arsyetimi ligjor*

Bazuar në 3 aktet e dorëzuara dhe në 5 dosjet e shortuara për subjektin, konstatohet se subjekti shfaq aftësi në arsyetimin ligjor të akteve. Këtë e tregon mënyra e qartë e pasqyrimin të rrethanave të faktit, analiza e provave dhe ballafaqimi i tyre me bazën ligjore të aplikueshme, si dhe përpilimi i kërkimeve të prezantuara në këto akte në mënyrë të saktë dhe të duhur, sipas kërkesave të ligjit. Vendimmarrja e prokurores, subjekt vlerësimi, e pasqyruar në pjesën arsyetuese është e qartë dhe të kuptueshme, ku evidentohet referimi në bazë ligjore. Ajo respekton rregullat e drejtshkrimin dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

Struktura e akteve është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur prokurori, ku konstatohet se në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.

### 2. Aftësitë organizative

#### a) *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

Në analizë të të dhënave të mësipërme, konstatohet se subjekti ka treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës, ku i ka kryer hetimet si dhe drejtuar e kontrolluar veprimtarinë hetimore brenda një afati të arsyeshëm në raport me kompleksitetin dhe shumëllojshmërinë e çështjeve.

#### b) *Aftësia për të kryer procedurat hetimore*

Subjekt rivlerësimi rezulton se ka kryer veprimet e duhura hetimore në kohë të arsyeshme. Nga ana e saj është realizuar mbledhja në kohë e provave dhe burimeve të provave të domosdoshme, të cilat janë vënë në bazë të akuzave të ngritura, të cilat janë dërguar për gjykim, si dhe sa i takon vendimmarrjes është kujdesur në njoftimin e subjekteve dhe palëve të interesuara, duke u bërë të ditur edhe të drejtën e ankimit, e faktuar kjo me shkresat përkatëse ose me nënshkrimin e tyre në aktet përkatëse.

#### c) *Aftësia për të administruar dosjet*

Subjekti ka treguar aftësi të mira në drejtim të përfundimit të hetimeve dhe rregullsisë së akteve dhe mbajtjes së tyre sipas një rregulli të mirëpërcaktuar. Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet proceduriale të përpiluara janë të sakta, të strukturuara, në respektim të normave të drejtshkrimin.

### **3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### **a) Etika në punë**

Nga aktet e dosjeve të shqyrtuara për efekt të procesit të rivlerësimit konstatohet nivel i pëlqyeshëm përgjegjshmërie në administrimin e duhur të akteve ligjore nga ana e subjektit të rivlerësimit.

#### **b) Integriteti**

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Subjekti, gjatë periudhës së rivlerësimit, nuk ka pasur masa disiplinore.

#### **c) Paanësia**

Në lidhje me vlerësimin e paanësisë për subjektin për periudhën objekt vlerësimi nuk rezultojnë të ketë patur raste të konfliktit të interesit dhe papajtueshmërisë për pjesëmarrjen në procedimet penale që i janë ngarkuar apo të jenë diskutuar cenim të të drejtave të pjesëmarrësve në proces apo të grupeve shoqërore të cënueshme. Në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementeve të tjera, që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### **a) Aftësitë e komunikimit**

Në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara në format letër dhe në 3 dokumentet e dorëzuara prej saj, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

#### **b) Aftësia për të bashkëpunuar**

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### **c) Gatishmëria për t'u angazhuar**

Në lidhje me vlerësimin e gatishmërisë për t'u angazhuar, për periudhën objekt vlerësimi, subjekti rezultojnë të jetë angazhuar në një sërë aktivitete profesionale të organizuara.

Subjekti i rivlerësimit ka marrë titullin “Jurist” në universitetin e Tiranës, ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës, profili “prokuror”.

Subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Gjithashtu, në periudhën e rivlerësimit, subjekti deklaron se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh jashtë Shkollës së Magjistraturës, duke shprehur gatishmërinë e saj për t'u rritur nga ana profesionale.

### **38. Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

**38.1.** Hetimi i Komisionit lidhur me këtë kriter është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të kryer nga KLP-ja dhe dokumentacionin bashkëlidhur tij; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e subjekteve denoncuese; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në

ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**38.2.** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavaruar 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjet penale të përzgjedhura me short si edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP.

**38.3.** Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga KLP, 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, 5 dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika lidhur me vlerësimin profesional.

### **39. Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit**

Në Komision janë paraqitur 15 denoncime, nga të cilat, subjektit i janë kërkuar shpjegime vetëm për denoncimin e mëposhtëm:

#### **1. S. R.<sup>81</sup>**

Denoncuesi pretendon se subjekti nuk ka bërë ankim në lidhje me një vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për deklarimin të pafajshëm të pandehurës së kallëzuar nga ana e tij. Ai pretendon se subjekti ka komunikuar me të pandehurën ditën e dhënies së vendimit.

Nga analizimi i dokumentacionin të depozituar nga ankuesi rezulton se subjekti ka kërkuar deklarimin fajtor të pandehurës dhe dënimin e saj me 6 muaj burg. Gjykata ka vendosur deklarimin të pafajshëm të së pandehurës. Ky vendim, sipas denoncuesit, nuk është ankimuar. Subjektit iu kërkuar shpjegime në lidhje me arsyet e mosankimimit të këtij vendim, si dhe në lidhje me faktin nëse ka komunikuar me të pandehurën ditën e dhënies së vendimit dhe cilat kanë qenë arsyet e këtij komunikimi.

#### **Në shpjegimet e saj të detajuara subjekti ka deklaruar:**

*“Me të pandehurën L. K. nuk kam patur në asnjë rast të vetëm komunikim personal, por vetëm procedural, lidhur me çështjen dhe gjithmonë në respektim të normave procedurale. Madje e pandehura dhe pala e saj mbrojtëse kanë qenë tepër të tensionuara karshi meje për faktin që e kisha dërguar çështjen për gjykim dhe këto janë të pasqyruara edhe në procesverbalin e seancës gjyqësore apo në konkluzionet e tyre përfundimtare. Po kështu, nuk është i vërtetë fakti që nga ana ime nuk është bërë apel kundër vendimit gjyqësor të sipërcituar, rrethanë kjo e cila i është sqaruar me shkresë edhe denoncuesit.*

*Më konkretisht:*

*Vendimi gjyqësor nr. \*\*\* datë 14.12.2018 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë me të cilën është deklaruar e pafajshme e pandehura L. K., më është komunikuar më datë 03.01.2019 dhe brenda afatit ligjor kam ushtruar ankim përcjellë në gjykatë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.01.2019. Apeli përbëhet nga 9 (nëntë) faqe, ku është arsyetuar pabazueshmëria në prova dhe në ligj e vendimit të gjykatës.*

*Me vendimin nr.\*\*\* regj. datë 29.01.2019 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, në vlerësimin tim në kundërshtim me ligjin, ka vendosur të mospranojë ankimin, duke arsyetuar se apeli është paraqitur jashtë afatit ligjor. Në këtë konkluzion Gjykata ka arritur, duke konsideruar si moment të komunikimit të vendimit momentin kur ftuesi i prokurorisë ka marrë vendimin dhe jo momentin kur vendimi realisht i është komunikuar prokurorit. Nënshkrimi në vendim dhe në regjistrin e njoftimit të vendimeve që Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mban për këtë qëllim, provon qartazi se prokurori ka marrë dijeni për vendimin më datë 03.01.2019. Ligji përcakton qartë atë që është shprehur edhe në pikën 3 të dispozitivit të vendimit të Gjykatës së*

<sup>81</sup> Denoncim nr. \*\*\*, datë 24.6.2019.

*Rrethit Gjyqësor, Tiranë nr.\*\*\* datë 14.12.2018: “Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së këtij vendimi, për prokurorin në mungesë (në shpallje), nga e nesërmja e marrjes dijani të vendimit”. Kam marrë dijani për vendimin më datë 03.01.2019 dhe brenda afatit ligjor më datë 16.01.2019 kam ushtruar Apel ndaj tij. Pavarësisht se apeli është ushtruar brenda afatit ligjor, Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë nuk e ka pranuar atë edhe pse nuk ka as kompetencë ligjore për të marrë një vendim të tillë<sup>82</sup>.*

*E ndodhur para kësaj vendimmarrje të Gjykatës, që në vlerësimin tim është pasojë e keqinterpretimit të ligjit, brenda afatit ligjor, kam ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit nr. \*\*\* regj. datë 29.01.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Në këtë recurs gjithsej 7 (shtatë) faqe, kam parashtruar të gjitha arsyet ligjore për prishjen e vendimit nr. \*\*\* regj. datë 29.01.2019 dhe dërgimin e ankimit kundër vendimit nr.\*\*\* datë 14.12.2018, për shqyrtim në Gjykatën e Apelit, Tiranë.*

*Sikundër mund të shihet qartë, lidhur me procedimin penal në ngarkim të të pandehurës L. K., kam respektuar dhe shfrytëzuar korrekt mjetet ligjore, duke filluar nga puna voluminoze hetimore për të provuar akuzën, arsyetimi i akuzës, mbrojtja e saj në gjyq, dënimi i kërkuar, apeli dhe deri te Rekursi në Gjykatën e Lartë. Nga të gjitha këto akte rezulton qartë qëndrimi im lidhur me çështjen apo me të pandehurën.”*

Komisioni, pasi i shqyrtoi provat dhe shpjegimet e subjektit, i konsideron ato bindëse.

## **2. Komisioni ka analizuar edhe procedimin penal nr. \*\*\*/2016, nga ku rezulton se:**

- a. në bazë të materialit të referuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Tiranë, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka regjistruar më 6.10.2016 procedimin penal nr. \*\*\* për veprat penale:
  - “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit E. E. L.;
  - “Shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit A. M. T.;
  - “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, regjistruar gjatë hetimit në ngarkim të shtetasit A. M..

Ky procedim ka filluar pasi në datën 4.10.2016 në emisionin investigativ "Stop" është denoncuar fakti se si punonjës të Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit, në mënyrë të jashtëligjshme shesin ose japin kundrejt shpërblimit automjete që janë në administrimin e kësaj të fundit. Rasti konkret i referohet magazinierit E. L., i cili, i kontaktuar nga gazetari i televizionit "Klan", i ka mundësuar atij dhënien e një motoçiklete të markës "\*\*\*\*" kundrejt shumës 10,000 (dhjetë mijë) lekë. Nxjerrja e motoçikletës nga magazina është mundësuar edhe nga shtetasi A. T, i cili ushtron detyrën e rojës së magazinës.

b. Prokurorja I. A. në përfundim të hetimit ka marrë vendim, duke u njoftuar akuzën si më poshtë personave të lartpërmendur:

- për z. E. L.: “Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, të parashikuar nga neni 259 i Kodit Penal;
- për z. A. T.: “Shpërdorim detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
- për z. A. M.: “Korrupsion aktiv i personave që ushtrojnë funksione publike”, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal.

c. Në datën 19.12.2016 është vendosur zëvendësimi i prokurores me subjektin e rivlerësimit.

Në datën 6.1.2017 subjekti ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të mëtejshme.

Subjekti i rivlerësimit më 27.2.2017 ka vendosur ndarjen e procedimit penal nr.\*\*\* në ngarkim të pandehurit A. M., duke krijuar një procedim penal të ri me nr. \*\*\* të vitit 2017. Sipas

---

<sup>82</sup> Shih nenet 407 e vijues të K.Pr.Penale.

subjektit hetimet janë të plota për të pandehurin A. M., i cili akuzohet për veprën penale të korrupsionit aktiv të personave që ushtrojnë funksione publike, parashikuar nga neni 244 i Kodit Penal, ndërkohë për të pandehurit E. L. dhe A. T., për të cilët, në përfundim të hetimit nga prokurorja I. A. ishte marrë vendimi duke u njoftuar akuzën, subjekti ka argumentuar se duhen kryer edhe një sërë veprimesh të tjera hetimore, por pa specifikuar cilat janë këto veprime.

d. Nga verifikimi i dosjes konstatohet se:

- deklaratimet e z. E. L. janë kontradiktore;
- nuk rezultojnë të jenë pyetur përfaqësuesit e kompanisë “\*\*\*” në lidhje me deklaratimet e z. E. L. se motoçikletën ia kishin falur ata.

Nga analiza sa më sipër, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit me konstatimet se: (i) subjekti duhet të kryente hetime të mëtejshme për të sqaruar deklaratimet kontradiktore të z. L.; (ii) subjekti duhet të pyeste përfaqësues të shoqërisë “\*\*\*” në lidhje me deklaratimet e z. E. L..

Në parashtrimet e saj, subjekti ka shpjeguar: “Pasi kam marrë dosjen në hetim jam gjendur para situatës që:

- Është marrë i pandehur për korrupsion shtetasi A. M., personi që ka qenë në cilësinë e gazetarit investigativ të Tv Klan, fakt i konfirmuar edhe nga Tv me kontratën përkatëse të punës. Shtetasi A.M. në vlerësimin tim, nuk duhet të merrej në përgjegjësi penale për rastin, pasi fakti nuk përbën vepër penale<sup>83</sup>;
- Janë marrë të pandehur shtetasit E. L. dhe A. T. pasi kanë nxjerrë dhe shitur një motoçikletë që supozohet të jetë në inventarin e Drejtorisë Rajonale të Rezervave të Shtetit, fakt ky i cili nuk ishte i konfirmuar nga kjo e fundit<sup>84</sup>. Nga ana tjetër i pandehuri E. L. ka pretenduar se motoçikleta është në pronësinë e tij personale dhe vetëm sa e kishte ruajtur në magazinën ku punonte.

Për sa më sipër, nga ana ime është konkluduar se për gazetarin A. M., nuk kishte nevojë për hetime të tjera, pasi rezultonte qartë se fakti nuk përbënte vepër penale. Kjo për sa kohë që ishte e provuar se ai ishte gazetar i Tv Klan dhe qëllimi i tij ka qenë jo të korruptojë apo të korrumpohet vetë, por të evidentojë raste korruptive të mundshme në Drejtorinë Rajonale të Rezervave të Shtetit. Ndërkohë për të pandehurit E.L. dhe A. T. do të duhet të kryheshin veprime të tjera hetimore. Kjo pasi ishte thelbesore për ekzistencën e veprave penale për të cilat ata ishin akuzuar që të provohej fakti se motoçikleta në fjalë ishte realisht në Inventarin e Rezervave të Shtetit apo ishte pronë personale e shtetasit E. L., sikundër ky i fundit ka pretenduar.

Në kohën që unë kam marrë çështjen në hetim rezultonte që shtetasi E. L. ishte pyetur nën hetim më datë 05.10.2016 dhe kishte shpjeguar se motorri ka dalë për skrap para 5 muajsh dhe tenderin e skrapit e ka fituar firma “\*\*\*”. Ka kontaktuar me punonjësin e kësaj firme<sup>85</sup>, i cili ia ka falur motorrin në fjalë.

Bazuar në këto shpjegime unë me cilësinë e prokurores së çështjes, kam nxjerrë më datë 06.01.2017 urdhrin për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore<sup>86</sup>, ku veç detyrave të tjera, lidhur me të pandehurin E. L., për të cilin ju kërkoni shpjegime, në pikën 2 të urdhrin është urdhëruar shprehimisht që të pyetet i pandehuri E. L. se cili ka qenë punonjësi i firmës \*\*\* që i ka dhënë motoçikletën dhe në ç’rrethana ia ka dhënë. Po kështu në vijim në pikën 3 të urdhrin, është urdhëruar shprehimisht që të verifikohen të dhënat e deklaruara nga E. L., nëpërmjet pyetjes së personave që do të rezultojnë nga firma \*\*\*<sup>87</sup> si dhe marrjes së dokumentacionit përkatës, nëse disponohet. Bazuar në urdhrin e mësipërm oficeri i policisë, ka pyetur më datë

<sup>83</sup> Argumentet janë dhënë në vendimin e prokurorit për pushimin e procedimit penal.

<sup>84</sup> Pranohet edhe nga prokurorja në arsyetimin e njoftimit të akuzës.

<sup>85</sup> Nuk ka deklaruar një emër.

<sup>86</sup> Shih faqen me numërtimin 32 të dosjes.

<sup>87</sup> Pasi E. L. të na jepte identitetin e punonjësit.

17.01.2017 shtetasin E. L. Është pyetur shtetasi K. R. dhe ka deklaruar se me shtetasin E. L. njihen pasi janë rritur në një lagje dhe e ka vazhduar shoqërinë me të edhe më pas. I pyetur ka konfirmuar faktin se motoçikletën tip “\*\*\*” ngjyrë të kuqe, ia ka dhënë ai para 5-6 vitesh. Është pyetur shtetasi Sh. F. dhe ka konfirmuar faktin se para 15-16 vjetësh i ka dhënë nipit të tij K. R. një motoçikletë të markës “\*\*\*” me ngjyrë të kuqe të cilën në atë kohë e ka sjellë nga Italia së bashku me mjete të tjera, si kamiona eskavatorë që ai ka importuar për firmën e tij të ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k. Me tonën nr.\*\*\* prot. datë 17.10.2016 i është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit lidhur me inventarin e mallit që ka patur në dorëzim magazinieri E. L., kohen e hyrjes së motoçikletës “\*\*\*” si dhe procedurat e ndjekura për hyrjen dhe nxjerrjen e automjeteve nga ambjentet DRRMSH. Në përgjigje të kërkesës sonë, DRRMSH me shkresën nr. \*\*\* prot. datë 24.10.2016, ndërsa na bën me dije procedurën që ndiqet për hyrjen dhe daljen e mallit nga magazina, sqaron në pikën 3 se “Nga ana jonë nuk mund të përcaktohet me saktësi momenti i hyrjes së mjetit “\*\*\*” për shkak se elementi bazë i identifikimit, numri i shasisë, është i paidentifikuar.” Me tonën nr. \*\*\* prot. datë 13.01.2017, i është rikerkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Rezervave Materiale të Shtetit dhe kjo e fundit me shkresën e saj nr. \*\*\* prot. datë 24.01.2017, na bën me dije se nga ana e tyre për arsye objektive nuk është përfunduar ende procesi i inventarizimit të mallit që ka patur në ngarkim shtetasi E. L.. Lidhur me motoçikletën në fjalë, sqarohet se: “Pergjithësisht në të shumtën e rasteve motoçikletat që dorëzohen nga strukturat e policisë së shtetit nuk e kanë të identifikuar numrin e shasisë. Në këto kushte është objektivisht e pamundur të përcaktohet saktë nga ana jonë momenti i hyrjes së motoçikletës tip “Vespa” ,me ngjyrë të kuqe, pasi numri i shasisë rezulton i paidentifikuar. Duke qënë se në funksion të ekzistencës së veprës penale për të cilën ishte akuzuar shtetasi E. L., do të duhej domosdoshmërisht të provohej fakti që motoçikleta në fjalë ka qënë në administrim të DRRMSH dhe jo pronë personale e shtetasit E. L., me tonën nr. \*\*\* prot. datë 03.02.2017 i jemi drejtuar sërish DRRMSH, duke kërkuar të na përcaktoje saktë nëse motoçikleta e sekuestruar për nevoja të këtij hetimi, është në inventarin e kësaj Drejtorie dhe në administrim të magazinierit E. L.. Në përgjigje të kësaj kërkesë, DRRMSH, me shkresën nr \*\*\* prot. date 09.02.2017 na informon se: “Nga komisioni i inventarizimit është vijuar me inventarizimin e motocikletave të cilat ka pasur në ngarkim ish magazinieri E. L. dhe nuk rezulton asnjë mjet me të dhënat “\*\*\* ngjyrë e kuqe pa targa dhe pa nr shasië”.

Gjithashtu në territorin e DRRMSH Tiranë, rezultojnë edhe 146 motoçikleta ardhur nga Komisariati Rajonal i Policisë Rrugore Tiranë, të cilat nuk janë bërë ende hyrje në inventarin e tyre pasi janë në proces plotësimi të dokumentacionit. Në këtë grup mjetesh ndër të tjera ekziston një motoçikletë me të dhënat të tipit “\*\*\*” \*\*\* ngjyrë e kuqe, pa targa dhe pa numër shasië. Nga evidentimi i bërë rezulton se ky mjet është gjendje në territorin tonë dhe se nuk ka mangësi edhe në kategorite e sipërcituara.

Të dhënat e siguruara nga hetimi, provojnë se motoçikleta tip \*\*\* që i është shitur shtetasit A. M., nga ana e shtetasit E. L., nuk është në inventarin e magazinës së Drejtorisë së Rezervave Materiale të Shtetit dhe as të ketë qenë në ngarkim të shtetasit E. L., si përgjegjës i magazinës ku ajo mbahej në ruajtje.

Në përfundim të hetimeve është analizuar se fakti që këtë motoçikletë personale, shtetasi E. L. e ruante në ambjentet e magazinës së DRRMSH, është një veprim në përmbushje jo të rregullt të detyrës së vet, ashtu sikundër edhe veprimet e rojes A. T. që ka lejuar të hyjë një person i paautorizuar në ambjentet e magazinës. Por rezulton e provuar gjithashtu që nga kjo mospërmbushje jo e rregullt e detyrës nga shtetasit E. L. dhe A. T. të mos ketë ardhur asnjë pasojë në fakt. Sikundër është paraqitur me sipër, motoçikleta në fjalë nuk ka qenë gjendje në magazinë.

Nga një analizë ligjore e të dhënave të siguruara nga ky hetim dhe dispozitave penale konkrete, konkludohet se shtetasit E. L. dhe A. T. nuk i kanë konsumuar elementët e veprave penale "Korrupsion pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike" parashikuar nga nenin 259 i K.Penal dhe "Shperdorim i detyrës" parashikuar nga neni 248 i K.Penal, për të cilat janë akuzuar përkatësisht, duke qënë se mungon krejtësisht ana objektive e këtyre veprave penale.

*Për sa u paraqit, më sipër nuk është pyetur punonjësi i Firmës “\*\*\*” i përmendur në deklarin e parë nga shtetasi E. L., jo sepse nuk ka qenë vullneti i prokurorit, pasi sikundër e kam cituar më sipër, prokurori ka urdhëruar pyetjen e këtij punonjësi pasi të identifikohet nga ana e shtetasit E. L.. Ky i fundit në deklarin e parë është shprehur se një punonjës i firmës Ç. ia ka falur motorin, pa dhënë identitetin e tij, ndërkohë që në deklarin e dytë, është tërhequr tërësisht nga ky deklarin, duke e cilësuar si të pavërtetë dhe se e ka thënë pasi nuk donte të deklaronte emra të tjerë personash. Në deklarin e dytë E. L. ka dhënë emrin konkret të personit që i ka dhënë motorin dhe nga ana jonë janë kryer veprimet deri në fund të zinxhirit të poseduesve të pretenduar të motoçikletës. Nga ana e tij nuk na është dhënë identiteti i punonjësit të firmës Ç. në asnjë moment, ndaj ka qenë e pamundur pyetja e këtij të fundit. Përveç sa më sipër, edhe nëse do të kishte qenë i identifikuar punonjësi i firmës<sup>88</sup>, pyetja e tij dhe shpjegimet që ai do të jepte nuk do të ndryshonin rezultatit e hetimit. Pra, nuk kishte rëndësi fakti nëse motorin shtetasi E. L., ia ka falur K. R., apo punonjësi i Firmës Ç.. Rëndësi dhe interes për hetimin paraqet fakti që motori në fjalë nuk rezultoi në pronësi dhe inventar të DRRMSH. Kjo ka qenë arsyeja që nga ana ime është insistuar me disa shkresa drejtuar DRRMSH, pasi nëse motoçikleta do të ishte në inventarin e saj, do të rrëzohej çdo pretendim i ngritur nga shtetasi E. L.. Për sa kohë motoçikleta rezultoi në pronësi të shtetasit E. L., nuk ka rëndësi për hetimin nëse atë ia ka shitur apo dhuruar punonjësi i firmës Ç. apo shtetasi K. R..*

*Për sa u shpjegua më sipër, rezulton që nga ana ime janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe të nevojshme hetimore në drejtim të provueshmërisë së elementëve të veprës penale konkrete dhe përgjegjësisë penale të autorëve.”*

Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme subjekti ka paraqitur aktet e mëposhtme:

- a) vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016;
- b) vendim për pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2017;
- c) urdhër për kryerjen e veprimeve të mëtejshme hetimore;
- d) procesverbal për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, marrë shtetasit E. L. më 5.10.2016;
- e) procesverbal për pyetjen e të pandehurit, shtetasit E. L., në datën 17.1.2017;
- f) procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, në datën 30.1.2017, shtetasit K. R. ;
- g) procesverbal për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, në datën 30.1.2017, shtetasit Sh. F.;
- h) vendime njoftim akuze, datë 9.12.2016 (3 të tilla);
- i) kërkesë për heqjen dorë nga çështja, datë 15.12.2016.

Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti ka ndjekur të gjitha hapat proceduralë të nevojshëm.

## **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**40.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLP-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e prokurorit.

**40.1.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

**40.2.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>88</sup> Pyetja rezultoi e pamundur në kushtet kur E. L. e cilësoi të pavërtetë deklarin e parë.

## **V. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se:

- i. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe;
- iii. subjekti ka një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Elsa Miha.
2. Vendimi i arsyetuar, me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më 11.2.2021

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela ZHEGU**  
Kryesuese

**Lulzim HAMITAJ**  
Anëtar

**Genta TAFA (BUNGO)**  
Relatore

*Sekretare gjyqësore*  
*Elda Faruku*